

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5955  
E hënë, 16 dhjetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Muja: Kosova ende nuk ka klimë të favorshme për investime F. 8-9

Drejtori i "Albania Minerals", Sahit Muja, ka shprehur interesim për të investuar në Kosovë, por ka thënë se ende duhet të përmirësohet klima e biznesit, çmimi i energjisë, i derivateve dhe i kamatave të larta nga bankat



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

**Muhamet MAVRAJ**



## DIGNITY! DREJTËSIA S'KA FOTOGRAFI

*Varësisht se në cilën parcelë të planetit  
T'i kanë shkërmoçur fëlçitë  
T'i kanë çmontuar brinjët  
Të kanë tretur në acid  
Apo kafkën ta kanë bërë llampadarë  
Dhe bashkë më të u tërhoqën në atë vrimën e  
minit*

*Ke fajin e vetëm që s'je si ata  
Drejtësia s'ka fotografi*

*Varësisht se çfarë feje ndoqi gruaja jote  
Se në cilin varr masiv ka njëren këmbë  
Ta kanë bërë hi  
E nga hiri sapun për fytyrën e humbur të  
Alfredit  
Dhe bashkë më të u tërhoqën në atë zgavrën  
e dhelpres*

*Mos u ligsho  
Drejtësia s'ka fotografi*

*Varësisht se çfarë ngjyre ke ti çifti i ri  
Të kanë la me tush gazi  
T'i kanë zgjidhë dhëmbët  
T'i kanë nxjerrë flokët  
T'i kanë vjedhë unazat e martesës  
Dhe bashkë më to u tërhoqën në atë jetën  
shpellare*

*Drejtësia s'ka fotografi*

*Vitet ngjeshen si fishekë plumbash  
Dekadat palohen si kuti bombash  
Mileniumi zgërdhiet me të qeshura atomike  
Çmenden, plaken a vdesin dëshmitarët  
Veçushat shqyjnë rrobat, grrithin fytyrën a  
hidhen nga shkëmbijtë  
bijtë e gjahtarëve duan t'u ngajjnë etërve  
mohuesit e gjenocidit marrin Nobelin për  
Paqen*

*Drejtësia s'ka fotografi*

*Se  
Fajet i kanë gratë dhe fëmijët  
Civilët e ngjuar në faltore me kokë në duar  
kolonat e refugjatëve  
Të sëmurët që operohen pa anestezion  
Mjekët e bombarduar  
Karrocieri që shtyn bukën e gojës në pazar,  
por nënës ia shpie kokën e vet të prerë*

*Pa panik  
Nuk u dridh planeti  
Po bjen çekani i monstrës  
Drejtësia s'ka fotografi*

*Mos u ligsho Luftëtar i Dritës  
Ti ke pas, ke dhe do të kesh gjithmonë diçka  
që ata nuk dinë as ta ëndërrojnë:  
Dignity*

Pristine, 15 dhjetor 2019

ANALISTËT POLITIKË KANË KOMENTUAR ZVARRITJEN E ARRITJES SË MARRËVESHJES LV-LDK

# LV-ja DHE LDK-ja NUK PO I BESOJNË NJËRA-TJETRËS

ANALISTËT:

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se zvarritja e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të

Kosovës (LDK) është duke ndodhur për shkak të mosbesimit që kanë këto parti mes vete. Faton Abdullahu, Blerim Vela dhe Ismet Kryeziu kanë thënë se këto dy parti

duhet të bëjnë kompromise për postin e presidentit dhe për çështjet e tjera. Sipas tyre, zgjidhja mund të jetë propozimi i një presidenti konsensual

SHPEND AHMETI KA DHËNË DORËHEQJE NGA POZITA E KRYETARIT TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE (PSD)

## Dardan Molliqaj zgjedhet kryetar i ri i PSD-së

Partia Socialdemokrate (PSD) nga e diela është bërë me kryetar të ri pas dorëheqjes së Shpend Ahmetit nga kjo pozitë. Dardan Molliqaj nëpërmjet

votesit të fshehtë ka marrë 83.7 për qind të votave në Kuvendin e PSD-së. Ndërkaq Shpend Ahmeti ka thënë se dorëheqja e tij nga pozita e kryetarit të

PSD-së vjen pas rezultatit të zgjedhjeve të 6 tetorit dhe ka njoftuar se nuk do të mbajë më asnjë pozitë në këtë subjekt politik



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Basha thotë se Rama po i shpall luftë fjalës së lirë

TIRANË, 15 DHJETOR - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka reaguar ashpër lidhur me paketën anti-shpifje të qeverisë. Paketën anti-shpifje të Ramës, Basha e quan paketa e anti-fjalës së lirë. Gjatë fjalës së tij në forumin e Akademisë politike të FRPD, Basha thotë se me këtë paketë ligjore, Rama kërkon t'i mbulojë dështimet e tij. "Kjo qeveri dhe ky kryeministër këtë të mërkurë do të paraqesë në Parlament dy pro-

jekt ligje që janë asgjë më pak se shpallje lufte ndaj fjalës së lirë. Asgjë nuk është e rastësishme, asgjë nuk po ndodh në mënyrë të befasishme. Për vite me radhë Shqipëria ka rënë poshtë e më poshtë në indeksin e lirisë së medias. Kjo qeveri do të fshehtë dhe maskojë dështimet dhe abuzimet e saj përmes pengimit të lirisë së fjalës dhe censurës së medias. Ja pse i duhet paketë e ashtuquajtur anti-shpifje, por në

fakt është anti fjalë e lirë. I duhet për të penguar daljen në shesh të aferave korruptive, të korrupsionit dhe hajdutërisë qeveritare që po shtohet dita ditës në Shqipëri edhe në këto ditë të emergjencës civile. Nismat ligjore për të penguar lirinë e shprehjes kanë vetëm një qëllim, të manipulojnë, të mbajnë të fshehura të vërtetat e gjendjes së keqe ku e ka katandisur kjo qeverisje vendin", tha Basha.



## Senati dhe procesi i hetimit për shkarkimin e presidentit Trump


Nëse Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, voton për ngritjen e akuzave për abuzim pushteti ndaj presidentit Trump, çështja kalon në Senatin e kontrolluar nga republikanët për një gjykim në fillim të vitit të ardhshëm

WASHINGTON, 15 DHJETOR - Qysh këtë javë Donald Trumpi mund të bëhet presidenti i tretë amerikan ndaj të cilit Dhoma e Përfaqësuesve ngrë akuzë për shkarkimin e tij. Nëse Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, voton për ngritjen e akuzave për abuzim pushteti ndaj presidentit Trump, çështja kalon në Senatin e kontrolluar nga republikanët për një gjykim në fillim të vitit të ardhshëm. Senati është një mjedis politik shumë më i favorshëm për presidentin, ka njoftuar voa.

Senati ka kaluar nëpër këtë rrugë në të kaluarën. Në vitin 1999 presidenti Bill Clinton u lirua nga akuzat se gënjeu dhe pengoi drejtësinë në lidhje me aferën e tij me praktikanten Monica Lewinsky. Në vitin 1868 presidenti Andrew

Johnson i mbijetoi me një votë një gjyqi në Senat pas ndaj tij u ngritën akuzat për shkelje të akteve të Kongresit që mbrojnë zyrtarët e lartë të qeverisë nga shkarkimi.

Në rastin e presidentit Trump, demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve e kanë akuzuar atë për abuzim të pushtetit dhe pengim të Kongresit në hetimin për dyshimet se presidenti i ka bërë presion Ukrainës për të hetuar një rival politik, demokratin Joe Biden. "Presidenti ynë ka nivelin më të lartë të besimit publik. Kur ai e tradhton atë besim dhe e vë veten përpara vendit, ai rrezikon Kushtetutën, demokracinë dhe sigurinë tonë kombëtare", thotë ligjvënësi Jerry Nadler, kryetar i Komisionit Juridik të Dhomës të Përfaqësuesve.



Presidenti Trump ka mohuar akuzat dhe po llogarit ndihmën e republikanëve të Senatit për ta liruar atë nga akuzat. "Demokratët e majtë radikalë dhe klasa e dështuar politike e Uashingtonit po përpiqen të fshijnë votat tuaja, të anulojnë zgjedhjet dhe të rrëzojnë demokracinë tonë. Kjo nuk do të ndodhë, mos u shqetësoni. Nuk do të humb asnjë sy gjumë për këtë", tha ai. Republikanët e Kongresit i kanë qëndruar besnik presidentit

Trump, në përjashtim të vetëm disa senatorëve që kanë shprehur kritika ndaj tij deri më tani, thotë Julie Pace. "Nuk do të thotë që ata do të votojnë për ta dënuar atë, por do të thotë që ne mund të shohim një skenar në të cilin të paktën do të kemi disa anëtarë të partisë së presidentit Trump që shprehin shqetësim të vërtetë për veprimet e tij me Ukrainën", tha Pace. Për të shkarkuar presidentin, nevojiten dy të tretat e Senatit, pra 67 nga 100 senatorët do të

duhej të mbështesnin akuzat për shkarkimin e presidentit Trump.

Kjo është e pamundur, thotë analisti Larry Sabato. "Unë nuk shoh asnjë rrugë përmes të cilës mund të merret mbështetja e 20 senatorëve republikanë për të votuar në favor të shkarkimit të presidentit Donald Trump. Ata mund të votojnë për shkarkimin dhe pastaj të shpallin dorëheqjet e tyre sepse ata nuk do të jenë në gjendje të qëndrojnë në postet e tyre për shumë kohë pas një votimit të tillë", tha ai. Pavarësisht nga rezultati, një gjyq në Senat mbi shkarkimin e presidentit do të jetë një provë e madhe për demokracinë amerikane, thotë senatori demokrat Mark Warner. "Unë do të shpresoj dhe lutesha që të gjithë kolegët e mi të Senatit do të reflektojnë dhe ta kuptojmë se kjo është ndoshta përgjegjësia më e rëndësishme kushtetuese që kemi", tha ai. Edhe nëse presidenti Trump i mbijeton një gjyqi në Senat, veprimet e tij mbi Ukrainën ka të ngjarë të jenë një çështje kryesore në fushatën presidenciale të vitit 2020.

## Vuçiçi i kundërpërgjigjet Haradinajt dhe Kurtit: S'dua t'i ofendoj, dua paqe

Beograd, 15 dhjetor - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, u është kundërpërgjigjur deklaratave të kryeministrit në detyrë të Kosovës, Ramush Haradinajt. Haradinaj, në një akademi përkujtimore të organizuar në 21-vjetorin e rënies së komandantit të Brigadës 113, Mujë Krasniqi dhe 40 dëshmorëve të kombit, ka thënë se Aleksandër Vuçiçi dhe kolegët e tij nuk mund ta mohojnë që djemtë e UÇK-së i kanë përzënë ata nga Kosova.

E për këto deklaratatë Haradinajt ka reaguar të dielën presidenti serb, Aleksandër Vuçiçi. Ai ka thënë se e ka kuptuar porosinë e Haradinajt, i cili tha se UÇK-ja e ka dëbuar Ushtrinë serbe nga Kosova, sikurse edhe Albin Kurtin, kur ka thënë se nuk do t'i japë territor Serbisë si ngushëllim për Kosovën e humbur. "Janë njerëz seriozë dhe porosi serioze, i kemi pranuar dhe kuptuar. Ata e dinë se cilat janë interesat e popullit të vet dhe

ne i dimë interesat e popullit tonë. Interesi ynë parësor është paqja dhe ruajtja e paqes", ka thënë Vuçiçi. Ai ka thënë se shqiptarët mendojnë se janë shumë të fuqishëm e serbët të dobët, duke shtuar se është më mirë që serbët të jenë të përgjegjshëm dhe seriozë, sepse e dinë se cilat janë interesat e tyre kombëtare dhe shtetërore. "Nuk më shkon mendja t'i ofendoj. Puna jonë është ta ruajmë paqen dhe të ndihmojmë popullin tonë të



qëndrojnë, të ketë sa më pak gjykime për vepra verbale. Më mirë të më gjykojnë mua sesa

popullin tonë. Mua gjithmonë më interesojnë veprat e jo fjalët", ka thënë presidenti serb.

Shpend Ahmeti ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të Partisë Socialdemokrate (PSD)

# Dardan Molliqaj zgjedhet kryetar i ri i PSD-së

Partia Socialdemokrate (PSD) nga e diela është bërë me kryetar të ri pas dorëheqjes së Shpend Ahmetit nga kjo pozitë. Dardan Molliqaj përmes votimit të fshehtë ka marrë 83.7 për qind të votave në Kuvendin e PSD-së, ndërkaq Shpend Ahmeti ka thënë se dorëheqja e tij nga pozita e kryetarit të PSD-së vjen pas rezultatit të zgjedhjeve të 6 tetorit dhe ka njoftuar se nuk do të mbajë më asnjë pozitë në këtë subjekt politik



Shpend Ahmeti tregon arsyet e dorëheqjes nga PSD-ja

Qendresa RAMA

**EPOKA E RE**

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Pas dorëheqjes së Shpend Ahmetit nga posti i kryetarit të Partisë Socialdemokrate (PSD), kjo parti të dielën ka zgjedhur kryetarin e ri, Dardan Molliqaj, i cili nëpërmjet votimit të fshehtë ka marrë 83.7 për të votave në kuvendin e kësaj partie. Prej pesë kandidatëve të propozuar për kryetar të ri të PSD-së, vetëm Molliqaj pranoi t'i hyjë kësaj gare.

PSD-ja përmes një njoftimi për media ka njoftuar për procedurat e zgjedhjes së Dardan Molliqajt në krye të kësaj partie. "Partia Socialdemokrate ka mbajtur sot mbledhje të Kuvendit, me ç'rast u votua për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Fillimisht u votua që të rritet numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues në 156, më pas u propozuan dhe u votuan anëtarët e rinj të këtij organi të partisë. Në këtë organ u aplikua plotësisht edhe kuota gjinore e votuar më herët, 50:50. Në pikën tjetër të rendit të ditës delegatët votuan për zgjedhjen e kryetarit. I propozuari Dardan Molliqaj përmes votimit të fshehtë mori 83.7 për qind të votave për, duke u zgjedhur kështu kryetar i PSD-së. Falënderojmë delegatët për pjesëmarrjen në këtë proces. Në ditët në vijim do të bëhet edhe zgjedhja e strukturave të tjera të partisë", është bërë me dije në njoftimin e PSD-së.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, përmes një njoftimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar për dorëheqjen nga pozita e kryetarit të Partisë Socialdemokrate (PSD). Ahmeti ka theksuar se ky vendim vjen pas rezultatit të zgjedhjeve të 6 tetorit. "Meqenëse tani kanë kaluar më shumë se dy muaj pas zgjedhjeve të 6 tetorit, kemi pasur kohë si Parti Socialdemokrate që ta vlerësojmë rezultatit zgjedhor dhe arsyet për rezultatit zgjedhor. Gjatë kësaj periudhe kemi diskutuar në kryesi disa herë. Përdërisa janë diskutuar arsye të ndryshme, ka qenë një emërues i

përbashkët i analizës, e ajo ka qenë që nuk drejtojmë gishta te asnjëri individualisht sepse të gjithë kemi pasur përgjegjësi për vendimet e marra e për të cilat besojmë se kanë qenë të arsyeshme e të drejta. Natyrisht se përgjegjësia më e madhe është e imja si kryetar i subjektit. Për të mos kërkuar përgjegjësi nga asnjëri individualisht, si kryetar i subjektit kam kërkuar mbledhjen e Kuvendit të PSD-së si organ më i lartë vendimmarrës në subjekt. Meqenëse edhe statuti i PSD-së kërkon mbajtjen e zgjedhjeve pas

zgjedhjeve nacionale për Kuvendin e Kosovës, sot kam kërkuar nga Kuvendi i PSD-së mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për të gjitha strukturat udhëheqëse të partisë, duke filluar nga kryetari. Kjo na mundëson që kolektivisht të reflektojmë dhe të marrim përgjegjësi si parti. Ky propozim u aprovua në mënyrë unanime dhe që nga sot PSD-ja do të ketë kryetar të ri dhe këshill të ri. Pastaj këshilli do ta votojë kryesinë e re dhe pozitën e tjera udhëheqëse në parti", ka shkruar

Ahmeti. Po ashtu, ai ka bërë me dije se nuk do të jetë më pjesë e asnjë pozite në PSD. "Po ashtu, ju njoftoj se unë kam vendosur të mos kandidoj për asnjë pozitë në parti. E para si marrje e përgjegjësisë për rezultatit zgjedhor, por arsyeja kryesore është angazhimi kryesor dhe i vetëm i imi në Komunën e Prishtinës. Tash e tutje dhe deri në përfundim të mandatit në Komunën e Prishtinës unë nuk do të marr asnjë angazhim tjetër në asnjë institucion tjetër duke u fokusuar plotësisht në përmbushjen e premtimeve të dhëna në vitin 2017", ka thënë ai.

Ahmeti ka shtuar se Kosova ka nevojë për opozitë të mirëfilltë e të fortë pa marrë parasysh se kush është në qeveri. "Jam i bindur se PSD-ja ka mjaftueshëm njerëz e kuadro profesionale për të udhëhequr, për ofrim të zgjedhjeve socialdemokrate, si dhe monitorim të qeverisë. Kryetari të ri dhe organeve të reja drejtuese u uroj suksese në sfidat e radhës. Socialdemokracia për mua mbetet rruga e vetme për zgjidhjen e problemeve shoqërore", deklaruar Ahmeti. PSD-ja në zgjedhjet e 6 tetorit hyri në koalicion parazgjedhor me AAK-në dhe nuk arriti që asnjë kandidat i saj të bëhet deputet.



## Kusari-Lila i garanton besnikëri LV-së, nuk mohon shkrirjen në partinë e Kurtit



PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Kryetarja e Alternatives, Mimoza Kusari-Lila, i ka quajtur spekulime dhe jokorrekte të gjitha zërat se ajo pritet të dalë jashtë grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Deputetja e zgjedhur nën logon e Vetëvendosjes, Kusari-Lila, i ka

garantuar besnikëri partisë së Albin Kurtit në legjislaturën e shtatë, teksa nuk mohon shkrirjen e tërësishme të partisë Alternativa në partinë fituese të zgjedhjeve të 6 tetorit. Për mundësitë e shkrirjes së Alternativës në Lëvizjen Vetëvendosje,

Mimoza Kusari-Lila, pa e mohuar, ka thënë për "Kosovapress" se nuk është koha për këtë diskutim, teksa përmend raportet e shkëlqyerë që ka me partinë e Albin Kurtit. Kryetarja e Alternatives u shpreh e gatshme që të jetë pjesë e qeverisë Kurti.

ANALISTËT  
POLITIKË  
KANË KOMENTUAR  
ZVARRITJEN E  
ARRITJES SË  
MARRËVESHJES  
LV-LDK



**Analistët:**

# LV-ja dhe LDK-ja nuk po i besojnë njëra-tjetrës

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se zvarritja e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është duke ndodhur për shkak të mosbesimit që kanë këto parti ndërmjet vete. Faton Abdullahu, Blerim Vela dhe Ismet Kryeziu kanë thënë se këto dy parti duhet të bëjnë kompromise për postin e presidentit dhe çështjet e tjera. Sipas tyre, zgjidhja mund të jetë propozimi i një presidenti konsensual

**Muhamet KOCI**

Prishtinë 15 dhjetor - Njohësit e rrethanave politike kanë vlerësuar se mosarritja e marrëveshjes për koalicionin qeverisës në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është duke ndodhur për shkak të dallimeve që kanë këto dy subjekte politike. Ata kanë bërë me dije se këto dy subjekte politike duhet të bëjnë kompromise të nevojshme për postin e presidentit dhe çështjet e tjera, në mënyrë që t'i hapet rruga krijimit të institucioneve të reja. Analisti politik Faton Abdullahu ka thënë për gazetën "Epoka e

re" se këto dy parti nuk i besojnë njëra-tjetrës. "Në rend të parë marrëveshja po zvarritet sepse këto dy subjekte dallojnë shumë saqë është shumë komplekse t'i besojnë njëra-tjetrës. Që të dyja këto subjekte nuk besojnë se do të ndryshojë sa duhet partneri tjetër qeverisës, sa për ta bërë ndryshimin për të cilin pretendojnë. Thjesht, po mungon besimi për ndryshim. Marrëveshja po zvarritet edhe pse përpjekja për të pasur më shumë pushtet nuk bazohet në vlerësimin real se kush sa ka fituar", ka thënë Abdullahu. Sipas tij, të dyja partitë në tavolinën e bisedimeve për qeverinë e re po ulen si fituese,

por po harrojnë se ato të ndara nuk mund të dalin se kanë fituar aq sa për të shtyrë përpara ndonjërin projekt për të cilët kanë bërë fushatë. "Për më shumë, si duket, LV-ja dhe LDK-ja, me mosbesimin që kanë ndaj njëra-tjetrës, nuk besojnë se qeveria e tyre e ardhshme mund të jetë në nivel të detyrës e të bëhet unike dhe efektive në dialog përballë Serbisë. Prandaj, çdo vonesë për ta themeluar qeverinë sikur u konvenon me shpresën se, ndoshta, kjo temë e nxehtë do të prolongohet e ndikuar nga zgjedhjet në ShBA apo edhe ato në Serbi. Aspak e guximshme dhe më pak e ndershme", ka thënë Abdullahu.

të humbë kuptimin e arsytimit për mosmarrëveshje. "Përderisa seanca konstituive e Kuvendit është caktuar më 26 dhjetor, LV-ja dhe LDK-ja kanë ende kohë të mbajnë takime dhe mos të arrijnë marrëveshje. Nga 26 dhjetori fillon të humbë kuptimi i arsytimit për mosarritje të marrëveshjes për bashkëqeverisje. Atëherë presioni publik si dhe humbja e mbështetjes ndaj partive do të shtohet dukshëm, që paradoksalisht do t'i krijojë kushtet për arritje të marrëveshjes së kompromisit", ka shkruar Vela në profilin e vet në "Facebook", duke shtuar se kompromis duhet të jetë presidenti konsensual. "Zgjidhja në fund mund të jetë një kompromis i ndërmjetëm, ku partitë e koalicionit propozojnë një kandidat apolitik për presidentin e vendit që do të mund të mbështetet nga opozita, pa pjesëmarrjen e së cilës në seancat plenare nuk do të mund të fillojë procesi i zgjedhjes së presidentit", ka vlerësuar Vela.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka deklaruar se formimi i koalicionit LV - LDK ka filluar të marrë karakter të situatave të vjetra politike. "Po i afrohem periudhës tremujore nga dita e zgjedhjeve, e takimet mes këtyre dy subjekteve përcillen me zvarritje, përplasje, edhe pa marrëveshje për të bashkëqeverisur. Kërkesat për zgjedhje të parakohshme menjëherë pas fillimit të qeverisë Haradinaj, po nga këto dy subjekte politike, po duket se në mungesë të kreativitetit politik, kanë qenë deklarata e parulla politike për konsum ditor, më shumë sesa angazhim për harmonizim të vlerave e përgjegjësi për udhëheqje të vendit", ka shkruar Kryeziu.

Ndonëse kishin paralajmëruar marrëveshje të shpejtë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, LV-ja dhe LDK-ja ende nuk kanë arritur pajtueshmëri për këtë edhe pas disa takimeve në mes të Albin Kurtit dhe Isa Mustafës. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, pas kërkesës së shumicës së partive politike, ka ndryshuar datën e thirrjes së mbledhjes së parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. "Duke respektuar kërkesën e shumicës së partive politike që kanë siguruar ulëse në Kuvendin e Kosovës, me sqarimin se data 24 dhjetor lidhet me pushimin për festën e Kërshëndellave, presidenti Thaçi ka vendosur që mbledhjen e parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta thërrasë më 26 dhjetor, në orën 15:00", është thënë në njoftimin e Presidencës.

Lëvizja Vetëvendosje në zgjedhjet e 6 tetorit ka dalë subjekti i parë politik, e dyta ka dalë Lidhja Demokratike e Kosovës.

# Drejt dialogut të marrëveshjes, pa kërkimfalje

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Përplasjet verbale ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë, të cilat kanë të bëjnë me të kaluarën, me luftën dhe me pranimin ose jo të krimeve të luftës, shpërfaqin dallimet thelbësore ndërmjet dy vendeve jo vetëm për të kaluarën, por edhe për të ardhmen e cila do të ndikojë shumë në raportet ndërmjet dy vendeve, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike, shqiptarë dhe serbë. Javën e kaluar presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka deklaruar se "krimi në Reçak ka qenë i fabrikuar", gjë që ka nxitur reagime të ashpra të autoriteteve të Kosovës, të cilat e kanë cilësuar këtë deklaratë si mohim të krimeve të luftës.

Politologu Ramush Tahiri thotë për "Radion Evropa e Lirë" se bazamenti i përplasjeve verbale ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë është koncepti të cilin Serbia e ka mbi luftërat në ish-Jugosllavi dhe i cili është i ndryshëm nga ai që kanë ish-republikat e tjera, përfshirë edhe Kosovën, e cila në përbërjen e shtetit të kaluar të përbashkët kishte statusin e krahinës autonome. Sipas tij, Serbia mendon që luftërat në ish-Jugosllavi kanë qenë civile, separatiste dhe për shkatërrimin e Jugosllavisë. Popujt e tjerë, siç thotë ai, mendojnë se ato kanë qenë luftëra të tyre për liri, përfshirë edhe Kosovën, e cila luftën me Serbinë e sheh si mënyrë për t'i shpëtuar gjenocidit dhe okupimit nga Serbia. "Nëse kjo çështje nuk zgjidhet, nuk mund të ketë marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sepse është e drejtë që pa e pranuar Serbia që pikërisht politika serbomadhe dhe pikërisht politika e (ish-presidentit serb, Slobodan) Millosheviqit ishte faktore për shkatërrimin e Jugosllavisë, nuk mund të ketë përparim. Në këtë luftë nuk mund të ketë dy fajtorë, por njëri do të jetë çlirimtar dhe tjetri okupes", ka thënë Tahiri.

Njohësi serb i çështjeve politike, Rangjel Nojkiq, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson që autoritetet e Kosovës dhe ato të Serbisë, përmes përplasjeve verbale lidhur me çështjen e krimeve të luftës, janë duke blerë kohë për rregullimin e problemeve të brendshme. "Kjo përplasje verbale është blerje e kohës për Prishtinën dhe Beogradin, marrë parasysh se ato nuk janë të gatshme që në këtë moment të bisedojnë. Në atë moment që bashkësia ndërkombëtare e sheh të arsyeshme që duhet ulur në tavolinë, do të harrohen të gjitha këto dhe do t'iu qasen atyre zgjidhjeve që janë të mundshme. Ka zgjidhje për të cilat duhet biseduar, marrë parasysh që marrëveshjen (e Brukselit) në mënyrë të njëjtë nuk e respektojnë as Beogradi e as Prishtina", ka theksuar Nojkiq. Të dy njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe juridike obliguese ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila do ta zgjidhte kontestin ndërmjet dy vendeve, nuk mund të ketë alternativë tjetër pozitive.

Por, se a do të trajtohen në një marrëveshje të tillë çështja e krimeve të luftës dhe kërkimfalja eventuale për ato krime, sipas tyre, është pak e besueshme.

Politologu Tahiri thotë se kërkimfalja e Serbisë për krimet e kryera në Kosovë më tepër është çështje emocionale e cila nuk ka ndonjë peshë të rëndësishme si çështje juridike-penale.

Ndërkaq, sipas tij, çështje juridike është që kriminelët që kanë kryer krime lufte të dalin para drejtësisë dhe të përgjigjen për krimet si dhe politika, e cila i ka shkaktuar këto krime, të gjykohej dhe të marrë një dënim. "Kërkimfalje nuk do të ketë dhe as që ka ndonjë tentim që të ketë. Derisa bëhet në politikat gjermane e patëm edhe (kancelaren) Merkel në Aushvic - pra, ata e kanë futur në ligj,

kundër fashizmit në ringjallje dhe kundër atyre që e mohojnë Holokaustin. Por, në Serbi, kjo e fundit konsideron se nga këto luftëra ka pësuar dhe nuk e ndien veten fajtorë", ka vlerësuar Tahiri. Nojkiq ka theksuar se shqyrtimi i krimeve të luftës, në një moment, do të vijë në rend dite. Por, sipas tij, tash për tash ende nuk janë pjekur kushtet për një gjë të tillë. Megjithatë, siç thotë ai, kur palët të pajtohen për një marrëveshje, atëherë ato do të ulen dhe të ballafaqohen me problemet e së kaluarës dhe që secila palë t'i pranojë mëkatet e veta. Por, brenda vetë marrëveshjes ai nuk pret të përfshihet një kërkimfalje për krimet e luftës. "Mendoj se kjo nuk do të bëhet, por në rast se bashkësia ndërkombëtare do ta kuptojë se një gjë e tillë është e domosdoshme. Fundja, ne kemi marrëveshjet nga luftërat e kaluara të Ballkanit, ku palët janë marrë vesh, por nuk ka pasur kërkimfalje në kuptimin që ajo edhe formalisht të shkruhet në marrëveshje. Kërkimfalja është e mundshme kur të ngrohen marrëdhëniet dhe kur të dyja palët të jenë të gatshme për diçka të tillë. Nuk pres që dikush të insistojë që diçka e tillë të qëndrojë në marrëveshje", ka deklaruar Nojkiq. Që të dy njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se përplasjet verbale ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe të Serbisë, lidhur me krimet e luftës, do të vazhdojnë edhe më tutje. Deklarata e presidentit serb, Vuçiq, e cila ka nxitur reagime në Kosovë, ka ardhur pas dënimit me 2 vjet burgim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, të ish-ministrit të Qeverisë së Kosovës, Ivan Todrosjeviq, për nxitje dhe përhapje publikisht të urrejtjes, përçarjes dhe mosdurimit ndërmjet grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Kosovë. Ky i fundit kishte deklaruar më 24 mars të këtij viti se "masakra e Reçakut ishte trillim" dhe që "terroristët shqiptarë e trilluan gjithë këtë".



Më tej, ai ka përmendur kompromiset që duhet t'i bëjnë këto parti për të arritur deri të marrëveshja. "Kompromisi më pragmatik që këto dy parti mund ta bëjnë për t'u arritur marrëveshja është besimi në shtetndërtim për të mirën e qytetarit dhe bindja se, para së gjithash, ne duhet të jemi unikë në përbashkësi me Serbinë. Do të ishte marrëzi politike dhe jo vetëm, që për shkak të kësaj apo asaj ministrie, këtij apo atij posti, të dështojë çdo gjë. Përndryshe, kompromis tjetër do të ishte që të dyja këto subjekte të pajtohen që presidenti nuk duhet të përcaktohet e vendoset nga ato në këtë tavolinë, sepse nuk e kanë as mandatin e as të drejtën. Presidenti i cili mund të dalë nga kjo marrëveshje LV-LDK mund të jetë çdo gjë, por nuk do të jetë kushtetues, sepse nuk do ta përmbushë kërkesën kryesore ligjore për këtë post, të qenit president unifikues", është shprehur Abdullahu.

Edhe analisti tjetër politik, Blerim Vela, ka vlerësuar se zvarritja e mospajtimeve në mes të LV-së dhe LDK-së mund

# I jepet lamtumira e fundit veprimtares së çështjes kombëtare Nazire Zogaj

FERIZAJ, 15 DHJETOR (ER) - Të dielën në teatrin "Adriana" në Ferizaj qindra qytetarë, të prirë nga kryetari i Komunës, Agim Aliu, deputetë të Kuvendit të Kosovës, zëvendësministra, përfaqësues e drejtues të institucioneve politike dhe shoqërore, drejtues të Shoqatës të Burgosurve Politikë të Kosovës, veprimtarë të çështjes kombëtare e familjarë të tyre nga të gjitha trojet etnike shqiptare, në hollin e teatrit i dhanë lamtumirën e fundit veprimtares e mësueses së dalluar, Nazire Zogaj, e cila të shtunën ndërroi jetë.

Në fjalën e tij në këtë mbledhje përkujtimore, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se humbën një grua, një familjare, një veprimtare, një sypatrembur e edukuese të brezave, humbën e po i japin lamtumirën e fundit ikonës së mospërkuljes, mësue-

ses së brezave, zonjës që në çdo shkronjë të kësaj fjale merr kuptim, Nazire Zogaj.

Ndërkaq kryetari i Shoqatës të Burgosurve Politikë të Kosovës, Hydajet Hyseni, ka evokuar kujtime dhe rrëfime nga periudhat e burgut të të ndjerës si dhe ka folur për veprimtarinë e përbashkët e rolin që kishte në demonstrimet popullore kundër robërisë serbe.

Vlerësime më të larta për personalitetin e të ndjerës, guximin, dijen dhe atdhedashurinë e saj dha edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, veprimtari dhe ish i burgosur politik Elmi Reçica. Ai ka thënë se Nazire Zogaj ka qenë një nga veprimtaret më të dëshmuara, më atdhetaret dhe më të sinqerta.

Fatbardha, e bija e së ndjerës, duke falënderuar qindra



pjesëmarrësit në këtë mbledhje përkujtimore, organizatorët që iu gjenden pranë familjes,

shpalosi një çast të veçantë e tejet emocional me të ëmën, atë të lënies së një fotografie nga

ajo, me emrat e tri vajzave të saj, e dedikimin prekës, kur ajo të mos jetë më.

## Shoqëria civile kërkon nga Haskuka shkarkimin e drejtorëve me aktakuza

PRIZREN, 15 DHJETOR (ER) - Organizatat e Shoqërisë Civile kanë kërkuar ruajtjen e integritetit institucional brenda Komunës së Prizrenit pas ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria kundër drejtorit të Drejtorisë Komunale për Ekonomi dhe Financa. Sipas organizatave "EC Ma Ndryshe", Fondacioni për Trashëgimi Kulturorë -Legatum, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), IPSIA, THY dhe X40, një zyrtar komunal në atë kohë ka paraqitur dorëheqjen nga posti i drejtorit të Drejtorisë Komunale për Ekonomi dhe Financa. "Prokuroria Themelore në Prizren më 3 dhjetor 2019 ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë kundër tre drejtorëve komunalë dhe dy personave të tjerë për shkak të dyshimit të bazuar se në



bashkëkryerje kanë kryer veprën penale 'keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' nga neni 422, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, pika 2.6, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së

Kosovës. Marrë parasysh mungesën e vullnetit individual të tre drejtorëve komunalë të cilët kanë aktakuzë të ngritur nga Prokuroria Themelore në Prizren për të reflektuar për dhënien e

dorëheqjes nga pozita e drejtorit të drejtorisë komunale", është thënë në reagimin e këtyre organizatave, duke kërkuar nga kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, që të ndërmarë veprime konkrete për shkarkimin e vartësve të tij ose për kërkimin e dorëheqjes së tyre. "Organizatrat e shoqërisë civile kujtojnë se premtimet elektorale të Haskukës ishin për vendosjen e standardeve për rastet e tilla dhe për ruajtjen e kredibilitetit institucional. Pasi që në rastin e drejtorit të drejtorisë për ekonomi dhe financa është zbatuar praktika e dorëheqjes, kërkojmë që edhe në këtë rast tre drejtorët komunalë të akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare të dorëhiqen ose të shkarkohen nga postet e tyre deri në vendimin e gjykatës.

Organizatrat e shoqërisë civile konsiderojnë se ndërmarrja e veprimeve konkrete për dorëheqje ose shkarkim të udhëheqësve të drejtorive komunale në rastet e ngritjes së aktakuzave do të tregonte vullnetin e sinqertë për përbushjen e premtimeve për rritjen e standardeve dhe ndryshimin e praktikave për të siguruar institucione me kredibilitet", është thënë në këtë reagim.

Më tutje, këto organizata kanë thënë se vazhdimi i punës për ushtrimin e funksioneve të larta publike të zyrtarëve që kanë të ngritura aktakuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare do ta ulë besimin e qytetarëve në institucionet lokale dhe do të shërbejë si një praktikë jo e mirë për arsyetimin e veprimeve pranë organeve të drejtësisë.

## Një muaj paraburgim për Xhabir Zharkun



FERIZAJ, 15 DHJETOR (ER) - Gjykata Themelore në Ferizaj ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në këtë qytet për caktimin e masës së paraburgimit për Xhabir Zharkun për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit". "I pandehuri Xh. Zh. dyshohet se në tetor të vitit 2008 dhe shkurt të vitit 2010 në Kaçanik, si person zyrtar, përkatësisht kryetar i Komunës së Kaçanikut, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë

pasurore për organizatën e biznesit dhe shkaktimit të dëmit të Komunës së Kaçanikut, ka shpërdoruar pozitën e tij zyrtare. Andaj gjyqtari i procedurës paraprake në Departamentin për Krime të Rënda, Mustaf Tahiri, kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e masës së paraburgimit kundër të dyshuarve e ka aprovuar të bazuar dhe të njëjtit i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaj", është thënë në njoftimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

# Trajnohen 1 700 infermierë të papunë edhe nga sektori privat

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Rreth 1 700 infermierë të papunë dhe të punësuar në sektorin privat po i nënshtrohen procesit të edukimit të vazhdueshëm profesional që do t'u mundësojë atyre grumbullimin e pikëve të mjaftueshme për rilicencim.

Elda Pasha është teknike e farmacistisë. Ajo punon në sektorin privat dhe është anëtare e Odës së Infermierëve të Kosovës. Elda duke punuar në sektorin privat ka pasur

shumë vështirësi për të ndjekur trajnime në fushën e edukimit të vazhdueshëm profesional. Një mundësi e tillë asaj i është mundësuar këtë të diel, kur me organizimin e Odës së Infermierëve të Kosovës, pa asnjë pagesë, po ndjek një trajnim në fushën e infermierisë.

Derisa po qëndronte në sallën e Klinikës së ORL-së, ku po mbahej trajnimi për infermierët dhe punonjësit e tjerë shëndetësorë që punojnë në sektorin privat, por edhe për ata që janë të papunë, Pasha ka shprehur mirënjohjen që

Oda e Infermierëve ua ka dhënë një mundësi të tillë. "Për ne ka qenë lehtësim shumë i madh duke pasur parasysh ndryshimin në paga që kemi mes teknikëve dhe farmacistëve, kostoja që ne po paguajmë për trajnimet e tjera është shumë e lartë. Për shembull, për konferencën e fundit që kam ndjekur kam paguar pesëdhjetë euro. Kjo e Odës ka qenë pa pagesë dhe kjo ka qenë shumë e mirëseardhur, sidomos që është organizuar ditën e diel, kur e kemi ditë të lirë në punë", ka thënë Pasha.

Ndërsa kryetari i Odës së Infermierëve të Kosovës, Naser Rustemaj, bashkë me dy zëvendëskryetarët dhe kryetarin e Këshillit Drejtues të OIK-ut, të dielën ka vizituar të gjitha pikat e trajnimit në shtatë regjione të Kosovës. Rustemaj ka përshëndetur aktivitetin që po mbahet në nivel vendi e për të cilin kanë shprehur interesim shumë të madh infermierët e papunë, por edhe ata që janë të punësuar në sektorin privat. "Ne gjithmonë si OIK do të mendojmë për vazhdimin e edukimit tuaj, që edhe ju, pavarë-

sisht se nuk jeni duke punuar, të keni mundësi të ndiqni trajnime nga fusha e edukimit të vazhdueshëm profesional", ka thënë Rustemaj.

Ai ka shtuar se OIK-u do të organizojë trajnime të paktën një herë në vit edhe për infermierët e papunë dhe ata që punojnë në sektorin privat. "Kështu që po shoh një interesim shumë të madh dhe këto trajnime do të mbahen në nivel të gjithë Kosovës", ka thënë Rustemaj. Në kuadër të këtij trajnimi po marrin pjesë 1 700 profesionistë shëndetësorë, anëtarë të OIK-ut.



# Kosova hapi Konsullatën e Përgjithshme edhe në Hamburg

PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Republika e Kosovës ka hapur edhe në Hamburg Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës. Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili ka qenë i pranishëm në hapjen e kësaj konsullate, ka thënë se është i lumtur që në Hamburg kanë përfunduar Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës e cila ka për qëllim forcimin e marrëdhënieve të Kosovës me Gjermaninë, ofrimin e shërbimeve më të mira dhe efektive konsullore për diasporën tonë që jeton në zonën përreth Hamburgut dhe Gjermanisë

veriore dhe të promovojë marrëdhënie ekonomike dhe tregtare. "Kjo Konsullata e Përgjithshme e dytë pas Dusseldorfit që hapim në Gjermani si pjesë e zgjerimit të rrjetit diplomatik dhe konsullor të Kosovës në Gjermani që të jemi më afër diasporës sonë. Tani Kosova përfaqësohet përmes Ambasadës së vet në Berlin dhe Konsullatave të Përgjithshme në Hamburg, Dusseldorf, Stuttgart, Munchen dhe Frankfurt në të gjitha cepat e Gjermanisë dhe me afër qytetarëve tanë që jetojnë në Gjermani", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".





Intervistë me drejtorin e "Albania Minerals", Sahit Muja

# Muja: Kosova ende nuk ka klimë të favorshme për investime

Drejtori i "Albania Minerals", Sahit Muja, ka shprehur interesim për të investuar në Kosovë, por thotë se duhet të përmirësohet edhe më tutje klima e biznesit, çmimi i energjisë, i derivateve dhe kamatave të bankave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka folur edhe për investimet konkrete në "Trepçë". "Ne jemi shumë të interesuar të investojmë dhe të marrim pjesë në tenderët publikë. Kemi institucione financiare që na kanë garantuar dy miliardë dollarë investim. 'Trepça' urgjentisht duhet të hyjë në punë, sepse është thesar i Evropës", ka thënë Muja

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 15 DHJETOR** - Drejtori i "Albania Minerals", Sahit Muja, ka thënë se në të gjitha bizneset që ai menaxhon ka të punësuar 1 200 punëtorë dhe se janë të fokusuar në fushën e mineraleve, teknologjisë së metaleve, baterive, si dhe energjisë së gjelbër. Sipas tij, Kosova ende nuk ofron klimë të favorshme për të investuar. "Klima e biznesit në Kosovë është e komplikuar, ka gjëra të mira që ofro-

hen, si taksat e vogla, fuqia punëtore dinamike dhe kostoja e lirë. Por, problemi madhor është korrupsioni. Po ashtu, çmimi i energjisë dhe i derivateve është shumë i lartë, kurse infrastruktura për të dalë me trena në dete nuk funksionon. Drejtësia në Kosovë nuk është në nivelet perëndimore. Kosovës i mungojnë shumë shkollat profesionale. Sistemi arsimor është shumë i dobët. Sistemi bankar në Kosovë është shumë i padrejtë, zhatës, me kredi me kosto të larta, ndërkaq

transporti ajror është nga më të shtrenjtët në botë", ka thënë Muja në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". Ai ka theksuar se Kosova është vend shumë i pasur me një larmi të gjerë mineralesh e metalesh të ndryshme. Sipas Mujës, në këtë lëmë Kosova duhet të jetë e kujdesshme dhe duhet të hapet për investimet e brendeve nacionale.

**"Epoka e re": Z. Muja, na tregoni fillimisht rreth afarizmit tuaj.**  
**Muja:** Ka rreth 25 vjet që merrem

me biznes në disa fusha. Në Turqi jam marrë me biznesin e metaleve të çmuara, ari, argjendi dhe platinë. Në Amerikë jam marrë me ndërtimtari, rikonstrukcion, blerje dhe shitje të pasurive të patundshme, restorante, me minerale dhe metale. Mementalisht jemi më shumë të fokusuar në industrinë minerale dhe në atë të energjisë së gjelbër. Si 'Albanian Minerals' ushtrojmë aktivitetet në mbi 50 shtete, ku bëjmë tregti dhe nxjerrje mineralesh. Në Shqipëri ka 10 vjet që investojmë shumë në industrinë minerale. Kemi arritur ta bëjmë minierën e kromit në Zogaj - Tropojë, më të madhen në Evropë. Kjo minierë ka një perspektivë të jashtëzakonshme për qindra vjet që vijnë. Në Pac të Tropojës këtë vit kemi prodhuar kromin më të mirë në botë. Në Lugun e Zi të Tropojës tashmë ka filluar prodhimi i magnezit dhe olivinit. Kjo minierë ka rezervën më të madhe në botë me

cilësinë më të mirë.

**"Epoka e re": Sa punëtorë keni dhe ku janë të fokusuar investimet e juaja?**

**Muja:** Në të gjitha bizneset kemi 1 200 punëtorë. Ne jemi të fokusuar në fushën e mineraleve, teknologjisë së metaleve, baterive, energjisë së gjelbër, teknologjisë nano dhe asaj robotike. Gjithashtu, vazhdojmë të investojmë në pasuritë e patundshme.

**"Epoka e re": Çfarë opinioni keni për klimën e biznesit në Kosovë?**

**Muja:** Klima e biznesit në Kosovë është e komplikuar, ka gjëra të mira që ofrohen, si taksat e vogla, fuqia punëtore dinamike dhe kostoja e lirë. Por, problemi madhor është korrupsioni. Ndërkaq çmimi i energjisë dhe i derivateve është shumë i lartë, kurse infrastruktura për të dalë me trena në dete nuk funksionon. Drejtësia në





Kosovë nuk është në nivelet perëndimore. Kosovës i mungojnë shumë shkollat profesionale. Sistemi arsimor është shumë i dobët. Sistemi bankar në Kosovë është shumë i padrejtë, zhvatës, me kredi me kosto të lartë. Transporti ajror është nga me të shtrenjtë në botë. Ndotja në Kosovë është në nivelet vdekjeprurëse. Pak i vihet rëndësi mjedisit, priten malet dhe ka lumenj të ndotur me mbeturina. Kuptohet uji i ndotur do të sjellë shumë probleme. Lumenjtë e Kosovës janë kthyer në gërmadha ku merret zalli pa kriter. Problemi më i madh është që rinia do që të largohet. Dëshira ime është t'i them fjalët më të mira për Kosovën, por ky është realiteti i sotëm.

**"Epoka e re":** Meqenëse në Kosovë kemi pasuri minerare dhe resurse nëntokësore, keni shprehur interesim për të investuar?

**Muja:** Kosova është vend shumë i pasur, me një larmi të gjerë minerale dhe metale të ndryshme. Kosova ka minerale industriale të shumëllojshme. Vlen të përmendën benttonitet, magnezitet, kalitet dhe clay. Më pas kemi minerale të shumta si alumini ose boksitet, kromi, nikeli dhe bakri. Kosova ka mbi 50 miliardë tonë linjit, një ndër rezervat më të mëdha në botë. Xehoret e "Trepçës" janë të klasës botërore në sasi dhe cilësi, pra zinku, plumbi, ari dhe argjendi. Kosova ka edhe minerale të rralla dhe një larmi të madhe të gurëve dekorativë. Ka vite që kemi pritur të

investojmë në "Trepçë". Kemi studiuar me shumë shkencëtarë e profesionistë. Kam blerë studimet dhe punën e çdo informacioni të ish-Jugosllavisë. "Trepça" është thesari i Evropës, por është në duart e kriminelëve ekonomikë të Kosovës. Në kohën e Jugosllavisë, sipas dokumenteve që kam, në vit qenë prodhuar katër milionë tonë, shkriheshin e bëheshin shumë produkte. Në "Trepçë" punonin afërsisht 25 000 punëtorë me paga të fuqisë blerës sa janë në Gjermani. Pra, ishte një gjigant ekonomik që gjeneronte mbi 10 miliardë euro me paratë e sotme. Si ka mundësi që ky thesar i pasohet nuk funksionon? Ku është shteti? Ku është Prokuroria e Kosovës që nuk bën hetime? Ku është populli i Kosovës? Pse flenë?

**"Epoka e re":** Meqenëse tani është shoqëri aksionare Qeveria e Kosovës, e cila ka 80 për qind të aksioneve, cila është mënyra më e duhur për ringjalljen e këtij gjiganti?

**Muja:** Me "Trepçën" është abuzuar më shumë nga shqip-folësit, të paktën pushtuesit serbë punonin me pagat më të larta të rajonit. Personalisht mendoj se shteti i Kosovës nuk ka ekspertë në qeveri të cilët kanë njohuri të duhura për ringjallje. Po, ju them se nuk ka vullnet, nuk ka vizon dhe nuk ka unitet për punët e mëdha që duhet të bëhen, në këtë rast edhe për ringjalljen e "Trepçës". Ndarja e hiseve pa asnjë meritë ishte e gabuar. Kjo pasuri është kombëtare dhe duhet të ringjallet. Këtu janë dy rrugë, njëra është deklarimi i falimentimit dhe marrja 100 për qind e këtij aseti kombëtar nga shteti, pra falimentimi dhe pasi të bëhet kjo duhet të ndodhë një tender i hapur, i cili duhet të jetë transparent ndërkombëtar. Të caktohen kushtet e tenderit minimum të kërkohet 2 miliardë euro investim, 4 milionë tonë prodhim vjetor dhe 10 000 vende pune. Me këtë investim bëhen fabrika të reja, linja prodhimi për produkte, investime në miniera, teknologji dhe investohet në shumë mekanizma të tjerë. Shteti cakton rentën minerale. Nga studimi ynë mbi 90 për qind e parave mbetën në Kosovë. Miniera nuk shitet, por jepet në koncesion për të punuar. Rruga e dytë është që ta mbajë shteti në pronësi dhe të sjellë menaxherë të zot që kanë njohuri në industrinë globale. Pra, duhet të investosh para në buxhetin e shtetit, të punësosh specialistë dhe jo njerëz partiakë. Unë kam shprehur vullnetin ta ndihmojë qeverinë e ardhshme si ekspert i kësaj fushe tash e 25 vjet. Ne jemi shumë të interesuar të investojmë dhe të marrim pjesë në tenderët publikë. Kemi institucione financiare që na kanë garantuar 2 miliardë dollarë investim. "Trepça" urgjentisht duhet të hyjë në punë sepse është thesar i Evropës.

# Maqedonia e Veriut fillon procedurat për autostradën Shkup - Bllacë

**PRISHTINË, 15 DHJETOR** - Afaristët në Maqedoninë e Veriut thonë se Qeveria e Maqedonisë së Veriut duhet t'i përshpejtojë procedurat për fillimin e ndërtimit të autostradës Shkup - Bllacë si pjesë e autostradës "Arbën Xhaferi", pasi në të kundërtën çdo ditë e humbur paraqet goditje për biznesin. Nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut thonë se punohet me ritëm të shtuar për tejkalimin e problemeve për fillimin e punimeve për ndërtimin e këtij aksi rrugor. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, thotë se tanimë janë paraqitur tri kompani për t'i ndërtuar dy kilometrat e para dhe pas kësaj pritet të fillojnë punimet që në fillim të vitit 2020. "Për momentin është duke u bërë evaluimi i ofertave të interesuara për ndërtimin e kësaj rruge. Për herë të parë po ndaj me ju se ka tri kompani të interesuara që kanë dorëzuar ofertat e tyre dhe pritet që pas evaluimit të ofertave jam i bindur se gjatë vitit të ardhshëm do të fillojnë punimet për ndërtimin e dy kilometrave të para të kësaj rruge. Paralelisht jemi duke e punuar edhe projektin bazë për 10 kilometrat e tjera kështu që në një afat shumë të shkurtër do ta kemi dhe

autostradën që do ta lidhë Shkupin me Bllacën dhe në atë mënyrë me siguri do të afrohem edhe me Kosovën", ka thënë Bekteshi.

Autostrada Shkup - Bllacë, e cila duhet të ketë katër tunele dhe tetë ura, do të kushtojë 110 milionë euro e që, sipas paralajmërimeve, korsi do të jenë të gjëra 3.5 metra, ndërsa gjerësia në një drejtim do të jetë 10.25 metra.

Autoritetet qeveritare kanë premtuar se autostrada Shkup - Bllacë e cila do ta lidhë Kosovën do të përfundojë në vitin 2023. Por, për afaristët është e pakuptimtë që më shumë se një dekadë të flitet për një aks rrugor që është vetëm 12 kilometra, e që realisht mund të përfundojë për gjysmë viti.

Ish-kryetari i Lidhjes së Odave të Maqedonisë, Mirçe Çekrexhi, për "Radion Evropa e Lirë" thotë se zhvillimi i ekonomisë, përkatësisht këmbimi tregtar, është ngushtë i lidhur me gjendjen e rrugëve. "Andaj prioritet duhet të jetë infrastruktura me vendet fqinje, duke pasur në fokus Kosovën për shkak të suficitit të lartë që ka Maqedonia e Veriut me këtë vend fqinj. Kjo rrugë në drejtim të Kosovës si partnere shumë e rëndësishme ekonomike, veçanërisht për faktin se me këtë shtet fqinj

kemi suficit, autoritetet shtetërore sa më shpejt duhet ta fillojnë ndërtimin dhe përfundimin e saj. Bëhet fjalë për 12 kilometra e cila rrugë, me të gjitha procedurat, mund të përfundojë për më pak se gjysmë viti nëse nuk taktizon politika", ka thënë Çekrexhi.

Afaristët thonë se, përveç infrastrukturës, që shihet si një problem kryesor, kompanitë përballen edhe me pengesa në dogana dhe me pritje të gjata në kufi, duke theksuar se kanë pësuar dëme të mëdha, veçanërisht për shkak të barrierave tregtare mes dy vendeve. Por, ministri i ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, thotë se ato tanimë i takojnë së kaluarës dhe se në komunikimin e drejtpërdrejtë javor që ka me homologun e tij në Kosovë, synohet të krijohen kushte më të volitshme për këmbimin tregtar mes dy vendeve. "Jam i bindur se bashkërisht do të gjejmë zgjidhje që barrierat tregtare t'i shndërrojmë në një komunikim sa më të madh në shkëmbim sa më të madh në mes dy vendeve për shkak se jemi dy vende fqinje dhe ka shumë vend që ne edhe më shumë ta rrisim shkëmbimin tregtar, pse jo edhe investimet e ndërsjella në mes dy vendeve, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës", ka shtuar Bekteshi.



Ministry of Infrastructure of Kosovo (Courtesy Image)

A mos na erdhi minishengeni nga qielli?! (2)

# Identifikimi i problemit në gjenezë



Nga Agron HOTI

Ideja e fuqizimit të bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor ka qenë pjesë e secilit takim, ku kanë marrë pjesë drejtuesit më të lartë politikë të Kosovës në të gjitha iniciativat rajonale. Edhe në samitet e procesit të Berlinit kanë marrë pjesë niveli më i lartë i politikës kosovare duke filluar nga viti 2014 e deri më sot. E Zona Ekonomike Rajonale, e cila i hap rrugë minishengenit, është pikërisht ajo për të cilën të gjithë drejtuesit politikë të rajonit vazhdimisht janë pajtuar, përfshirë ata të Kosovës. Bile edhe kryeministri në ardhje, Albin Kurti, parimisht nuk ishte kundër minishengenit, duke thënë se "është dashur të pritej formimi i qeverisë e pastaj të vendosej për minishengen". Problemi me të cilin shumë shpejt do të mund të përballemi është se çfarë do të thotë spektri politik i Kosovës, nëse presidenca kroate e BE-së, që fillon nga 1 janari 2020, do ta fuste në rend dite formimin e minishengenit, duke ditur që Zona Ekonomike Rajonale do të jetë paraprijëse e minishengenit? A do të jemi në gjendje që t'i kundërvihemi një ndërmarrjeje të tillë? Nëse i lëshojmë një sy rrafshit ndërkombëtar, shohim se krijimi i Zonave të Tregtisë së Lirë (Free Trade Areas) dhe

Unioneve Doganore janë trende globale të paanashkalueshme. Që nga viti 1967 kemi Zonën e Tregtisë së Lirë ASEAN (Association of Southeast Asian Nations) në përbërje të Indonezisë, Singapurit, Malajzisë, Filipineve, Vietnamit, Bruneit, Kamboxhës, Myanmarit dhe Laosit; nga viti 1991 kemi Mercosur në përbërje të Brazilit, Argentinës, Uruguait dhe Paraguait; nga viti 1994 kemi NAFTA (North American Free Trade Area) në përbërje të ShBA-së, Kanadasë dhe Meksikës. Edhe Turqia ka Union Doganor me Bashkimin Evropian që nga viti 1995. Që nga viti 1951 kemi Bashkësinë Evropiane për Thëngjill dhe Çelik (BETHÇ) në përbërje të Gjermanisë, Francës, Italisë, Holandës, Belgjikës dhe Luksemburgut. Nga BETHÇ rrodhi ajo që sot e njohim si Bashkimi Evropian që ka tregun e përbashkët, unionin doganor, valutën e përbashkët dhe sistemin shengen me lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve. E Bashkimi Evropian, në rrafsh global, shihet si forma më e avancuar dhe më e suksesshme e integritimit rajonal në botë deri më sot. Nuk duhet harruar se hapja dhe unifikimi i tregjeve ishte bazë për BE-në. Mbi këtë bazë u hapën rajone të ndryshme në glob duke hyrë në Zona të Tregtisë së Lirë, shpesh në shpërputhje me klimën mes shteteve pjesëmarrëse si rezultat i së kaluarës komplekse mes tyre. Kush do ta kishte besuar që Gjermania dhe Franca do të pajtoheshin kur kjo e para e kishte sulmuar Francën në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore?! Kush do të kishte

besuar që Polonia dhe Izraeli do të bashkëpunonin me Gjermaninë pas Holokaustit?! Kush do ta kishte besuar që investitorët japonezë do ta vërshonin bregdetin kinez dhe jug-korean me investime multimiliardëshe duke qenë pushtues i tyre?! Kush do të kishte besuar që BE-ja do të hynte në Union Doganor me Turqinë duke marrë parasysht klimën që ekziston në BE mbi Turqinë ose e kundërta?! Në një situatë normale, minishengeni do t'u bënte mirë ekonomive të Ballkanit Perëndimor duke rritur shkëmbimin e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe mobilitetin e njerëzve. Por, Kosova, duke pasur probleme serioze me Serbinë dhe Bosnje Hercegovinën, është e vështirë ta paramendosh mirëfunksionimin e një minishengenit, pavarësisht se si do të dukej. Nëse thuhet shengenit ka funksionuar mirë mes vendeve të BE-së dhe rrjedhimisht do të duhej të funksiononte edhe në Ballkan Perëndimor, ky do të mund të kundërgarmentohej duke thënë se vendet e BE-së janë futur në shengen me kushte të barabarta dhe njohje të ndërsjellë, kurse futja e Kosovës në një minishengen me Serbinë dhe Bosnje Hercegovinën, përderisa këto të fundit nuk e njohin shtetësinë e Kosovës dhe aq më tepër bëjnë pengesa të vazhdueshme kundër pavarësisë dhe eksporteve të Kosovës, do ta bënte jufunksional çfarëdo minishengenit. E njëri prej argumenteve për moshyrje në minishengen do të ishte mosfunksionimi adekuat i marrëveshjes së CEFTA-s (Central European Free Trade Agreement) mes Kosovës,

Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Ky është argumenti kryesor që spektri politik i Kosovës është dashur ta theksonte para konceptimit dhe krijimit të çfarëdo iniciative rajonale e jo ta heshtë atë. Një minishengen që nuk përfshinë 6 vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë i dështuar. Nëse Serbia, Bosnja e Hercegovina do ta njihnin pavarësinë e Kosovës dhe ta shihnin Kosovën si partnere e barabartë, atëherë një minishengen do të mund të kishte kuptim. Argumenti se Serbia do të jetë shteti më i fortë në minishengen nuk qëndron për ta kundërshtuar atë nga Kosova ose Shqipëria, sepse po të ishte ashtu atëherë as BE-ja nuk do të ekzistonte, sepse brenda saj ka Gjermaninë si shtetin më të fortë karshi Francës, Italisë e shumë shteteve të tjera, ose edhe nafta nuk do të funksiononte, sepse ShBA-ja është shumë më e fortë sesa Meksika dhe Kanadaja, nuk do të funksiononte as Mercosur duke pasur Brazilin si shtetin më të fuqishëm në të, ose siç nuk do të mund të funksiononte Asean duke pasur Indonezinë shtetin më të fuqishëm në të. Fundja, edhe kur Kosova të futet në BE aty do të ketë Gjermaninë dhe shtete të tjera që janë shumë më të fuqishme. Gjithmonë, në një Zonë të Tregtisë së Lirë, Union Doganor apo formë tjetër të lidhjes mes shteteve, ka pabarazi mes shteteve në aspektin e zhvillimit ekonomik. Edhe Turqia është më e dobët sesa BE-ja, por ka hyrë në Union Doganor me BE-në, sepse përfitimet nga hapja janë shumë më të mëdha sesa nga mbyllja. E gjitha që u tha më lart tregon

se pa u arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme mes Kosovës dhe Serbisë do të jetë fatkeqësisht tepër i vështirë, nëse i pamundshëm, thellimi i bashkëpunimit rajonal. Tashmë dihet që sa i përket arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse kemi në njërin anë BE-në, e cila përmes minishengenit mundohet që dalëngadalë t'i përafrojë aq shumë vendet e Ballkanit Perëndimor sa një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ishte para faktit të kryer dhe, si rrjedhojë të arrihej, ndërsa në anën tjetër kemi qëndrimin amerikan që kërkon arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse sa më shpejt që të jetë e mundur, diçka që pastaj do t'i hapte përsëri rrugë integritimit të plotë rajonal dhe evropian. Spektri politik i Kosovës pa përjashtim duhet ndërprerë praktikën e deklaratave ditore për përfitime ditore për hir të elektorateve të veta dhe ta arrijë konsensusin e nevojshëm për tema të mëdha. Nëse vërtet kemi qenë kundër minishengenit është dashur ta themi të gjithë që nga gjeneza e tij e filluar në Samitin e Triestës në korrik 2017, nën udhëheqjen e presidencës italiane të BE-së, e jo vazhdimisht t'u themi po iniciativave të ndryshme e jo pastaj kur ato na shërbejnë të heshtim, kundërshtojmë apo të japim arsytet të çuditshme. Një qasje e tillë na ul seriozitetin para BE-së dhe iniciativave të ndryshme rajonale. Pra, duhet të jemi plotësisht koherentë dhe konsistentë në hapa politikë, përndryshe do të jemi vetëm konsumues të iniciativave e aspak bashkëprojektues të tyre. (Fund)

## Ramës i kërkohet anulimi i Samitit të Durrësit

PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Mohimi i masakrës së Reçakut nga shteti i Serbisë ka bërë që në mesin e shumë arsyeve të tjera, partitë politikë në Kosovë të kërkojnë nga Shqipëria një qasje tjetër ndaj Serbisë dhe ta anulojë Samitin e Durrësit në mes tri shteteve, Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut për ta themeluar të ashtuquajturin Minishengen Ballkanik. Katër partitë parlamentare, përfshirë dy partitë fituese të zgjedhjeve të 6 tetorit në Kosovë, Vetëvendosje dhe LDK-ja, kanë thënë se nuk mund të flitet për asnjë bashkëpunim rajonal me

një shtet që i mohon krimet e veta. Anëtarja e kryesisë e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, është shprehur për "Kosovapress" kundër takimeve të tilla, veçmas tash kur haptas mohohet gjenocidi i kryer në Kosovë nga Serbia. Kundër këtij bashkëpunimi rajonal u shpreh edhe deputeti i zgjedhur i LDK-së, Anton Quni, i cili ka thënë se fillimisht Serbia duhet të ballafaqohet me të kaluarën e vet. Ndërsa ish-shefi i grupit parlamentar i PDK-së, deputeti i zgjedhur Memli Krasniqi, duke kërkuar anulimin e Samitit në



Durrës, ka thënë për "Kosovapress" se qasja e shtetit shqiptar duhet të ndryshojë karshi Serbisë, pasi në këtë formë, duke mohuar krimet, nuk

mund të shkohet përpara. Në anën tjetër, nënkryetari i AAK-së, Ardian Gjini, ka kërkuar reagim nga të gjitha vendet mike të Kosovës për mohimin e

masakrës së Reçakut, teksa ka thënë se deklaratat e tilla duhet ta ndërpresin çfarëdo bashkëpunimi mes shteteve. Tentimet për formimin e një Minishengenit Ballkanik kanë filluar para rreth dy muajve, ku fillimisht tre liderët, Aleksandër Vuçiq, Edi Rama dhe Zoran Zaev, janë takuar në Novi Sad të Serbisë, pastaj në Ohër të Maqedonisë Veriore. Është paraparë që më 21 dhjetor të takohen në Durrës të Shqipërisë. Kjo iniciativë është duke u parë si e rrezikshme për Kosovën si në aspektin politik, po ashtu edhe në atë ekonomik.

## Si u ekzekutua diktatori Çausheku së bashku me të shoqen

**BUKURESHI, 15 DHJETOR** - Revoltat kundër diktatorit komunist të Rumanisë, Nikolae Çausheku e shtynë këtë të fundit dhe gruan e tij, Elenën të largoheshin me shpejtësi nga Bukureshti më 22 dhjetor të vitit 1989.

Por pavarësisht tentativës së tyre për shpëtim, çifti u kap nga policia lokale në Tërgovishte. Një gjyq i shkurtër u zhvillua më 24 dhjetor ndërsa në fund të tij Elena dhe Nikolae Çausheku u ekzekutuan. Ish-paraushtaraku Jonel Boeru

kujton ditën kur vrau diktatorin rumun, Nikolae Çausheku dhe gruan e tij Elena Çausheku. Në një intervistë për "Mirror", Boeru tha se ishin 29 plumbat e dalë nga AK-47 e tij, që vranë diktatorin dhe gruan, Elena.

Kapiteni rëfeu se tirani 71-vjeçar ishte veshur me stil dhe vinte erë e rëndë solucioni pasrojtës.

"Fjalët e fundit të Çaushekut ishin: Jetë të gjatë Republikës Socialiste të Rumanisë- të pavarur dhe të lirë", tha Boeru.

Ai shtoi se Elena Çausheku mbante erë të keqe.

Fjalët e saj ishin krejt të ndryshme. "Ajo i ulëriti një ushtari: Ti shkërdhatë!"

Ishte koha kur "Perdja e hekurt" kishte nisur të binte në Evropën Lindore me disa revolucione paqësore. Çausheku urdhëroi trupat që të qëllonin mbi protestuesit. Më shumë se 1100 njerëz u vranë në tri javë, përpara se tirani të rrezohej pas 22 vjetësh drejtim.



# Dështimi i presidentëve amerikanë në Afganistan

Qindra intervista, të realizuara me gjeneralë të lartë dhe qeveritarë afganë, me ambasadorë, zyrtarë të ndihmës e këshilltarë politikë, tregojnë se si presidentët njëri pas tjetrit, nga Bushi tek Obama e Donald Trumpi, nuk arritën gjë tjetër veçse krijimin e një shteti të dhunshëm, të korruptuar dhe jofunksional, që mezi u mbështet nga armët e ShBA-së

**LONDËR, 15 DHJETOR** - Një tufë dokumentesh të publikuara këtë javë kanë nxjerrë në pah mungesën e koherencës në qasjen që ka pasur që në fillim Uashingtoni në Afganistan. Të ashtuquajturat "Afghanistan papers", përmbledhin dëshmi të cilat japin tablonë e një lufte të shënjuar nga dështimi, thotë the "Guardian", një kontrast i thellë ky me historinë e triumfit që tregojnë zyrtarë amerikanë e britanikë.

Qindra intervista, të realizuara me gjeneralë të lartë dhe qeveritarë afganë, me ambasadorë, zyrtarë të ndihmës e këshilltarë politikë - tregojnë se si presidentët njëri pas tjetrit, nga Bushi tek Obama e Donald Trumpi, nuk arritën gjë tjetër veçse krijimin e një shteti të dhunshëm, të korruptuar dhe jofunksional, që mezi u

mbështet nga armët e ShBA-së. Ato nxjerrin gjithashtu në pah se si Bashkimi Sovjetik në fillim, e më pas ShBA-ja me aleatët e saj, "ngecën" keq në Afganistan prej një kombinimi të vetëbesimit të tepruar dhe injorancës, ndërsa liderhipi amerikan, si me Bushin ashtu dhe Obamën, shqetësohej më shumë për politikën e brendshme sesa për ndikimin e vendimeve të tij në Afganistan. Richard Boucher, ndihmës sekretar i Shtetit për çështjet e Jugut dhe të Azisë Qendrore në periudhën e viteve 2006 dhe 2009, thotë se kontraktat që rrethuan qëllimin e tij, e bënë këtë një mision të bazuar në pamundësi.

"Nëse mendojmë se strategjia jonë e daljes është ose t'i mposhtim talebanët - gjë që nuk mund të bëhet duke marrë parasysh rrethanat lokale,



rajonale dhe ndërkuftare - ose të krijojmë një Qeveri afgane e cila të jetë e aftë të sigurojë një qeverisje të mirë për qytetarët e saj duke përdorur mjetet dhe

metodat amerikane, atëherë mund ta them se nuk kemi një strategji daljeje sepse të dyja këto janë të pamundura", ka thënë ai. Përmbledhja që

Boucher i bën me pak fjalë situatës ndërkohë, është edhe më tronditëse: "Ne nuk dinim se çfarë bënim", është shprehur ish-zyrtari i lartë.

## Jeremy Corbyn kërkon falje për humbjen

**LONDËR, 15 DHJETOR** - Udhëheqësi kryesor i opozitës në Britani, Jeremy Corbyn kërroi falje të dielën për zhvillimin e një fushate shkatërrimtare që i dha kryeministrit Boris Johnson një mandat për ta nxjerrë Mbretërinë e Bashkuar nga BE-ja muajin e ardhshëm.

Por socialisti veteran mbrojti platformën e tij të majtë dhe fajësoi median për performancën më të dobët të partisë së tij që para Luftës së Dytë Botërore.

"Nuk e fsheh. Rezultati i zgjedhjeve të enjten ishte një goditje për të gjithë ata që kanë nevojë dëshpëruese për ndryshim të vërtetë në

vendin tonë", tha Corbyn në gazetën "Sunday Mirror".

"Do të doja ta bashkoja vendin që unë e dua, por më vjen keq që nuk arritëm dhe unë marr përgjegjësinë time për këtë", tha Corbyn.

Zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme të së enjtes u shndërruan në një rivotim të referendumit për anëtarësim në BE të vitit 2016 në të cilin Johnson kryesoi çështjen Brexit.

Johnsoni tani ka një shumicë prej 80 vendesh në Dhomën e Komunave me 650 anëtarë - një diferencë të cilën e ka pasur për herë të fundit Margaret Thatcher në

vitet 1980.

I zymtë por luftarak, Corbyn tha se do të tërhiqet nga posti pasi partia e tij Laburiste të përfundojë një periudhë "reflektimi" në lidhje me gabimet e saj.

Partia pritet të ketë një udhëheqës të ri përpara se Anglia të votojë përsëri në zgjedhjet lokale në maj. Megjithatë, 70-vjeçi nuk ka një pasardhës të qartë pas një viti luftimesh mes protektionistëve të vjetër të mbështetur nga sindikatat dhe anëtarëve me pamje evropiane.

Corbyn u përpoq të gjente një ekuilibër mes dy kampeve duke



marrë një pozitë neutrale për Brexit - një vendim që sipas zëdhënësit të financave të laburistëve John McDonnell dëshmoi se ishte fatal.

"Ajo që ne u përpoqëm të bënim është t'i bashkojmë të dy palët dhe dështuam", tha McDonnell për BBC-në.

Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (7)

# Rezistenca nuk kishte të ndalur në bjeshkët e Pashtrikut



LULZIM SAHITI

Rezistenca nuk kishte të ndalur, mirëpo duhej ndërrimi i pozicioneve nga një vend në tjetrin. Me përkushtim e maturi të rrallë, Afrim Musliu kishte filluar tërheqjen e shokëve në të djathtë të bjeshkëve të Pashtrikut, rreth 100 metra nga vendi ku forcat serbe sulmonin pandërprerë. Aty do të pozicionoheshin prapa një shkëmbi së bashku me ushtarët: Baki Rashiti nga Petrova, Sadri Krasniqi nga Karaqica, Rifat Mujota nga Mollopolci, Idriz Hysenaj nga Petrova, Astrit Bytyqi, Nusret Musliu nga Reçaku, Selim Selimi, Hyzri Salihaj, i njohur me nofkën "Cëhëja" nga Mollopolci, Bashkim Beqaj "Paçuku" nga Shtimja, Hazir Kryeziu, Enver Olluri, Hyzri Musliu nga Belinci, Shemi Dobruna, Veli Ballazhi, Avni Shiti, Vebi Mici, Besim Qarri, Beqir Luma e të tjerë. Pas 10 minutave, luftëtarët: Hazir Nezir Kryeziu (42-vjeçar, i zhdukur) nga Mleçani dhe Enver Zymer Ollurin (19) nga Krojmiri i Lipjanit tërhiqen nga ky pozicion duke shkuar teposhtë luginës së Pashtrikut, mirëpo ballafaqohen ballë për ballë me armikun dhe në këtë betejë të pabarabartë bien dëshmorë për të mos vdekur kurrë. Pjesa tjetër e ushtarëve të UÇK-së qëndrojnë të barrikaduar dhe nuk lëvizin rreth 12 orë nga ky vend deri sa është errësuar. Pas rënies së mjegullës, Baki Rashiti tuboi disa rripa nga lëkura dhe ka ndezur ngjyrën e këpuceve për t'u ngrohur. Po sa hiqej mjegulla, me borë e shuanin zjarrin për të fshe-

hur gjurmët nga forcat armike. Kështu kalojnë rrezikun gjatë kësaj dite mirëpo ushtarët serbë nuk rrinin duarkryq, kishin lëshuar qentë për të gjurmuar nëpër mal. Përsëri duhej syçelëti e të ishin të kujdesshëm. Sapo vinin qentë kufitarë afër ushtarëve të UÇK-së, ata me topa bore i gjuanin për t'i trembur, kështu që të mos identifikoheshin pozicioni i tyre e duke mos i përdorë armët e zjarra. Kështu e largojnë rrezikun e radhës.

Pasi kishte kaluar rreziku, Afrimi me shkathtësinë që kishte udhëzoi luftëtarët të rifillojnë tërheqjen përpjetë bjeshkëve të thepisura të Pashtrikut. Ai me kondicionin që kishte zakonisht çante borën për të çelur shtegun, pas të cilit ecnin në kolonë: Rifati, Sadriu, Idrizi, Astriti, Nusreti, Selimi, Bashkimi, Hyzri, Veliu, Beqiri e të tjerë. Me jelekun e veshur antiplumb prapa kolonës shkonte Baki Rashiti si mburojë e fortë e shokëve. Fillimisht tentojnë të dalin në shtegun nga kanë ardhur prej Shqipërisë, mirëpo duke ecur Bashkim Beqaj për pak ka qenë duke rënë në rrjetën e minave armike, ndërsa në të njëjtën kohë Idriz Hysenaj duke u mbajtur për thike të pushkës, ka shkrepur aksidentalisht një plumb në tokë. Detyrohen të kthehen mbrapa duke lakuar rrugën për t'u ngjitur më lartë, mirëpo nga lodhja e madhe kishte humbur vetëdijen Hyzri Salihaj dhe ishte shtrirë në borë. Pas tij, vjen Idrizi dhe e godet pa dashje me këmbë për të zgjuar nga agonia dhe për fat arrin ta këndellë. Përsëri vazhdojnë rrugën së bashku me shokë tjerë, dhe jo shumë larg nga aty, kësaj radhe hasin në kukulla me veshje ushtarake. Me të parë, ushtarët e UÇK-së shtangën në vend duke menduar se ranë në pritën e forcave jugosllave. Për të parë më mirë këtë, Nusret Musliu kishte një palë dylibi të natës. Me këtë rast, kanë vërejtur se pranë kukullave mashtruese ishte karakolli i Ushtrisë Jugosllave. Në çdo çast mund të ndodhte ndon-



Pashtrik, nga e djathta në të majtë: Isuf Abazi, Afrim Musliu dhe Arben Hyseni

jë befasi e pakëndshme, mirëpo, si njohës i mirë i këtij terreni, Afrimi, largon panikun nga ushtarët duke ju treguar se forcat armike kanë vendosur kukulla të minuara dhe duhet pasur kujdes të shtuar gjatë tërheqjes nga kjo zonë e rrezikshme. Nata ishte akull e ftohtë por kjo nuk i ndalte çlirimtarët të ecnin. Mbi vetullat e secilit kishte rënë vesë e bardhë, e cila nga lagështia e ajrit ishte ngrirë, ndërsa në mustaqet e Rifat Mujotës, një shtresë e hollë kristalesh ishte formuar nga ngrija e avullit që dilte nga goja e tij. Dalëngadalë një pjesë të ushtarëve vjen duke i lëshuar fuqia dhe gjatë ecjes mbushën frymë. Idriz Hysenaj dhe Hyzri Musliu bënin përpjekje të vazhdueshme në ndihmë të shokëve të luftës: Besim Qarri, Selim Selimi dhe Astrit Bytyqi. Ndërkohë vjen një erë e rrëmbyeshme sikur tornado nga fuqia e së cilës rrëzohen në borë të gjithë ushtarët. Këtu, vorbulli i erës bënë shkëputjen e këtyre ushtarëve me pjesën tjetër që ishin pak më para. Të gjithë mbërrijnë në maje të Pashtrikut, në lartësinë mbidetare prej 1700

metra, por tash ishin ndarë në tri grupe. Natën ndërmjet 14 - 15 dhjetorit, Vebi Mici bashkë me Avni Shitin e kalojnë përjashta një bunkeri të mbushur me dhe nga të reshurat atmosferike. Për t'u ngrohur, ata grumbullojnë krënde dhe ndezin do rroba civile që kishin me vete. Për të ndez zjarrin nxjerrin barutin nga fisheku. Në këto rrethana të rënda shpeshherë ishte në pyetje edhe gjindshmëria dhe përvoja jetësore. Ndërsa pak më lartë, qëndronin Idrizi, Selimi, Besimi, Astriti dhe Hyzri Musliu, të cilët e kalojnë natën bashkërisht. Ndërkaq, Afrimi, Veliu, Baki, Rifati, Bashkimi, Nusreti, Avni, Sadriu, Beqiri, Shemi dhe Hyzri Salihaj kanë qenë vetëm pak metra më tutje. Në realitet, grupet e tyre ishin shumë afër njëri me tjetrin por ata këtë nuk e dinin sepse moti i lig e pamundësonte orientimin dhe kontaktin në mes vete. Mjaftonte vetëm pak metra të ishe mbrapa grupit dhe më askush nuk mund të binte në gjurmë.

Tashti lufta me armikun kishte mbaruar por vazhdonte lufta tjetër me motin e ftohtë, i cili vështirësonte lëvizjen e ushtarëve. Temperatura ishte rreth minus 20 gradë celsius. Era kishte grumbulluar borën nëpër gropa e hendeqe që ishin vështirë të kalueshme. Mbretëronte errësirë e madhe, mjegull e dendur që papritur kishte mbështjellë majat e maleve të Pashtrikut. Nga acari i madh dëgjohej pëlcitja e degëve të lisave. Frynte një erë e ftohtë që të përlante nga të katër anët. Shumica e ushtarëve të UÇK-së kishin veshmbathje të lagështa dhe ndjenin rraskapitje të përgjithshme. Qëndrimi i gjatë në natyrë, në temperatura ekstrem të ulëta tashmë kishte bërë të veten duke shkaktuar ftohjen e pjesëve periferike të trupit: Hundën, veshët, gishtat, duart

dhe shputat. Mandej, kishte filluar tek ta të shfaqej lodhja, hutia dhe ndjenja e madhe për gjumë. Sipas rrëfimeve të pjesëmarrësve në këtë ngjarje, thuhet se të gjitha funksionet trupore dhe psikike u ngadalësuan tek ushtarët që atë natë bridhnin poshtë e lartë pa ditur orientimin se nga do të shkojnë. Madje, tek disa ushtarë filluan të lajmërohen edhe ëndrrat dhe të shfaqen halucinationet.

Në mëngjes, më 15 dhjetor, Astriti kërkon nga Idrizi dhe Hyzriu që të shkojnë te stanet për të kërkuar ndihmë për tërheqjen e tyre. Të tretë ishin dërmuar sidomos nga lodhja e të ftohtit e madh, mirëpo Idrizi para se të nisej ia kishte shtruar xhaketen e vet, Besimit. Mandej, vazhdojnë rrugën e pafund dhe pa adresë. Ecin shtigjeve të Pashtrikut nëpër borë, të mbështjellë sy e vesh nga të ftohtit, pa ditur orientimin se nga do të shkonin. Kushtet atmosferike kishin ngatërruar orientimin e tyre në natyrë, ku mjegulla e dendur vështirësonte të gjendej rruga e daljes matanë Kosovës. Në maje të Pashtrikut, nga mesi i ditës e shohin Veli Ballazhin, duke ecur i vetmuar si në labirint. Për çudi kalojnë pranë njëri-tjetrit pa shkëmbyer asnjë fjalë. Sërisht i zë nata të dy së bashku pa bërë asnjë zgjedhje për shokët dhe veten e tyre gjithashtu. Ndërkaq, në orët e pasdites së 16 dhjetorit, Idriz Hysenaj dhe Hyzri Musliu takojnë rastësisht dy ushtarët e fshatit Dimcë të Hanit të Elezit, Vebi Micin dhe Avni Shitin, me të cilët pak pa u errësuar kanë parë një helm të ushtarake të hedhur në borë dhe një shirit të verdhë ndriçues të lidhur për një shkurre. Përmes tyre marrin një orientim dhe arrijnë të shkojnë me shumë mundime te stanet. Nga aty nisën për në bazën e tyre në Vlahën. (Vijon)



Ushtarët çlirimtarë gjatë rugëtimit të tyre nëpër bjeshkët e Pashtrikut



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**PASHTETË PULE**

gluten free

100% mish pule

*cilësi e garantuar*

pa konservues


E rrallë

## Peshqit e çuditshëm pushtojnë plazhin

Mijëra krijesa të çuditshme kanë pushtuar një plazh në Kaliforni. Krijesat pulsuese janë krimba në formë dhjami, ose "Urechis caupo". Edhe pse ato janë një lloj krimbi, ato janë quajtur gjerësisht si "peshku penis". Krimbat futen thellë në nën rërë, por stuhitë e ditëve të fundit i nxorën nga toka dhe Drakes Beach është mbuluar nga krijesat. Ka prova fosile të krijesave që datojnë 300 milionë vjet dhe disa jetojnë deri në 25 vjet.



FOTO E DITES



Një person shihet me veshjet e Babadimrit në një akvarium në Seul të Koresë së Jugut. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Qyteza norvegjeze ku mund të shkojë kushdo për punë, pa viza fare

Qyteza Arktik Longyearbyen është në një ishull, pjesë e arkipelagut Svalbard, midis Norvegjisë dhe Polin të Veriut. Ishulli është një zonë ku kushdo mund të shkojë pa viza për të jetuar e për të punuar. Ka qenë pjesë e Norvegjisë që në vitin 1920, kur u popullua për herë të parë. Kjo qytezë ka 2 500 banorë nga 51 kombësi të ndryshme.



## BARSOLETA E DITËS



- Pse zihen në mes vete dy bionde mbi një motor?  
- Shtyhen për ta zënë vendin kah dritarja.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

## The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

## FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

## FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

**Regjia:** James Mangold



## Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

**Rolet:** Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

**Regjia:** Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



### DASHI

Një fillim dite i mbarë dhe sot


pirëni ta ndihmoni këdo që ka nevojë për ju. Miqtë dhe partneri janë të lumtur që ju kanë pranë.



### DEMI

Bëni mirë të tentoni marrëveshje

jashtë shtetit sepse kanë më shumë mundësi financiare. Do të arrini ta bëni dallimin midis dy personave afër jush.



### BINJAKËT

Sot, nëse tregoni gënjeshtër, do të

zbulohen shumë shpejt. Mundohuni të jeni të qartë në gjërat që ju nevojiten për një projekt.



### GAFORRJA

Jeni në paqe me veten sot dhe me

personat që keni pranë. Bazohuni në informacionet që keni për të zgjidhur një çështje të komplikuar.



### LUANI

Në sytë e njeriut të zemrës duhet

të jeni të përkryer dhe kjo ju bën të jeni sa më të vëmendshëm dhe në detaje ndaj vetes tuaj.



### VIRGJËRËSHA

Jeni të ndrojtur dhe mjaft të rez-

ervuar në çfarëdo situatë që ju paraqitet sot. Temperamenti juaj nuk ju lejon të bëni eksperimente.



### PESHORJA

Momente të shkuarës ju vijnë në

mendje, por pa qenë aq shumë thelbësore në vendimet tuaja të së tashmes. Një surprizë e këndshme do t'ju befasojë.



### AKREPI

Megjithëse me buxhet të

reduktuar kohët e fundit, pasuria e brendshme është aq e bollshme sa ndiheni personi më i pasur në botë.



### SHIGJETARI

Çdo gjë përreth jush

buzëqesh sot sepse edhe ju vetë i falni buzëqeshjet pa kërkuar asnjëherë asgjë në këmbim.



### BRICJAPI

Miqësitë e reja do t'ju tregojnë që jeni

persona që te të tjerët përçoni veçse mirësi dhe energji pozitive. Kjo gjë do t'ju shoqërojë edhe në ambientin e punës.



### UJORI

E kotë që përipieni të

fshiheni pas gishtit. Sot në çdo çast do të krijoni tensione që nuk janë shumë të nevojshme.



### PESHQIT

Keni vendosur të jeni besnik të

ideve tuaja fillestare dhe do t'i mbronni ato pa bërë kompromise. Kjo gjë mund t'ju penalizojë në disa raste.


## Justin Timberlake fton gruan ta shoqërojë në xhirimet e filmit pas skandalit të fundit



**K**ëngëtari dhe aktori i njohur Justin Timberlake është duke u munduar t'i rregullojë raportet me gruan e tij, Jessica Biel, pasi është fotografuar duke i mbajtur duar me aktoren Alisha Wainwright, në xhirimet e filmit

"Palmer". Një burim i afërt i familjes i tha "Us Weekly", se ai e ka ftuar gruan e vet ta shoqërojë atë gjatë xhirimeve të këtij filmi. Kjo, sipas tij, për t'ia dëshmuar asaj se nuk ekziston asgjë ndërmjet Justinin dhe Alishas.

## Chris Browni publikon fotografinë e parë të djalit



**K**ëngëtari i njohur Chris Brown ka publikuar për herë të parë në rrjete sociale fotografinë e djalit të vet Aeko Catori Brown. Ai në 'Snap' ka publikuar fotografi të ndryshme me të birin. Djali i tij erdhi në jetë në nëntor të këtij viti. Ai është i ndarë nga nëna e të birit, Ammika Harris.




## Jennifer Lopez dhe Alex Rodriquezi shikojnë ndeshjen e basketbollit bashkë

**A**ta u fejuan përsëri në mars gjatë një propozimi romantik ndërsa ishin në plazh në perëndimin të diellit në Bahamas. Jennifer Lopez, 50-vjeçare dhe Alex 'A-Rod' Rodriguez, 44-vjeçar, u shfaqën

si çdoherë çift i dashur. Këtë herë ata vendosen që së bashku të shikojnë një ndeshje të Lakersit në Miami. Gjatë lojës të dyve u dhuruan fanellat blu me pseudonimet e tyre mbi ta nga ekipi me seli në Florida.

## Adhuresi bën tatuazh fytyrën e Bebe Rexhës në krah



**K**ëngëtarja e njohur shqiptar Bebe Rexha ka bërë me dije se një adhures i saj ka një tatuazh interesant në trup. Ajo me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram" ka thënë se ai bëri tatu

fytyrën e saj në krah. Rexha duket se është ndier e lumtur me këtë veprim dhe dedikim që i është bërë asaj. "O Zoti im, ky është dedikim i vërtetë", ka qenë mbishkrimi i kësaj fotografie.



# Bajroni që i konsideronte grekët si 'kopukë qerratenj'



**Nga: Faik KONICA**  
(Marrë nga revista "Albania",  
Viti 9, Nr. 8, 1905)  
Përktheu nga frëngjishtja:  
Monet MANESHI

"Ja tek e pa veten në breg të panjohur, nga të gjithë admiruar, kur shumëkush tutet duke e vështruar"... Me këto vargje nis Kënga e dytë e Çajld Haroldit dhe tërë ajo vazhdimësi strofash magjepse që do pavdekësonin shqiptarët, tek kishin nevojë për pavdekësi. Duhet lëçitur e rilëçitur ato faqe për të ndërë thellë entuziazmin që i ngjallte Bajronit Shqipëria dhe shqiptarët; por, para atyre këngëve me burim hyjnor, ne vazhdojmë të parapëlqejmë letrat, shënimet, kujtimet, gjithçka që, e shkruar nga penë më familjare dhe më pak e përpunuar, shfaq më shumë gjendjen shpirtërore të Lord Bajronit.

Ballkani gjëmonte në atë kohë nga emri i një shqiptari i cili, bujar i thjeshtë, kishte arritur

aq fuqi sa të kërcënonte seriozisht praninë e turqve në Evropë. Lavdia e Ali Tepelenit ishte shtrirë madje gjer në Perëndim; kështu mbreti Gustave-Adolphe, duke shkuar për në Jeruzalem, ktheu rrugë enkas për t'u pjekur me të. Lord Bajroni, në një letër drejtuar së ëmës (Letra nga Preveza, 13 tetor 1809), flet për udhëtimin e tij nëpër Shqipëri dhe pritjen që i bëri atij Aliu i Tepelenës:

"Përshkova brendësinë e viseve të Shqipërisë për të vajtur e për t'i bërë vizitë pashait. Shkova në Tepelenë, vendlindja e Lartësisë së tij (his Highness's birth-place) rreth njëqind e pesëdhjetë milje larg që këtej, ku ndenja tri ditë. Pashai quhet Ali dhe është njeri me shumë zotësi; qeveris krejt Shqipërinë, domethënë: Ilirinë e lashtë, Epirin dhe një pjesë të Maqedonisë".

Përshtypja e atij udhëtimi gjithë magjepsje, përmes maleve të Shqipërisë, me bukuri të zymtë dhe madhështore shfaqet kryesisht tek poema e Çajld Haroldit. Ai i tregon së ëmës vajtjen e tij në Janinë: "Kur mbërrita në Janinë, kryeqyteti i tij, pas një udhëtimi prej tri ditësh, mësova se Veziri ishte në Iliri, me ushtrinë e tij, për të rrethuar Ibrahim pashën në kështjellën

e Beratit. Kishte marrë vesh se një anglez i shquar kishte ardhur për të vizituar shtetet e tij dhe kishte dhënë urdhra që, me të mbërritur unë, të më gatitnin një shtëpi dhe të më jepnin falas gjithçka që do të ishte e nevojshme. U bëra disa dhurata shërbenjësve, por as që bëhej fjalë që unë të paguaja gjithë sa konsumoja për vete". Dhe më tej: "U hipa kuajve të Vezirit dhe vajta të shoh sarajet e tij dhe ato të nipërve; janë gjithë shkëlqim, por si shumë zburuar me ar e mëndafshe."

Nuk do vonojë dhe ai do rifillojë udhëtimin me kalë përmes udhëve të gjata, monotonia e të cilave i shpërblehet me hijeshinë e trevave që përshkon, "me bukurinë më fshatarake" që ka parë mëndonjëherë. Pas nëntë ditësh, sos në Tepelenë. Ja se si e tregon pritjen që iu bë: "Më shpunë te një salloni i shkëlqyer dhe vjen sekretari i pashait që më pyeti për shëndetin. Aliu më priti të nesërmen. Kisha veshur një uniformë të plotë oficeri të shtatmadhorisë dhe mbaja një kordhë të hijshme. Salla ishte e shtruar me mermer: një shatërvan mes saj lëshonte ujët, ndërsa muret ishin veshur me qilima të kuq otomanë. Veziri më priti në këmbë, veçori e madhe nga

ana e një myslimani, dhe më uli në krahun e tij të djathtë. Kisha marrë me vete një terxhuman për raste të veçanta, por këtë herë, një mjek i Aliut, i quajtur Femlario, dhe që e kuptonte latinishten, përbushoi funksionin e duhur. Kërkesa e parë e pashait ishte se përse unë kaq i ri, isha larguar nga vendi im. Shtoi pasandaj se ministri anglez, kapiteni Leake, i kishte thënë se unë vija nga një familje e madhe; dhe m'u lut të përcillja nderimet e tij për time më, dhe unë po ua paraqes ato në emër të Ali Pashait. Më tha se ishte i bindur që unë isha njeri nga sërë e lartë, ngaqë i kisha veshët e vegjël, leshrat me bukle dhe duart të holla e të bardha; nuk e fshehu që sjellja dhe kostumi im i kishin pëlqyer. M'u lut ta konsideroja si një baba, për aq kohë sa do të isha në Shqipëri, duke më siguruar se më shihte si birin e tij; në fakt, më trajtoi si një fëmijë, duke më dërguar njëzet herë në ditë bajame, sherbete, fruta dhe gliko".

Shfaqja e maleve të Shqipërisë, "me epërsi të dukshme në bukuri, krahasuar me peizazhet më tërheqëse të Greqisë", veçoria e zakoneve, karakteri kalorësiak i shqiptarëve, kostumi i tyre "më i shkëlqyeri në botë", gjithçka do t'i bëjë Bajronit

përshtypje të tillë që do t'i mbetet në mendje përgjithnjë. Admirimi dhe simpatia që ushqen për "bijtë krenarë të Shqipërisë" shfaqen në fjalën më të vogël që thotë. Dhe domosdo, nuk do të ishte me interes të paktë po të tregohesh përkrah kësaj simpatie dhe këtij admirimi për shqiptarët -, përbuzja e fshehur keq që i ngjallte "greku gënjeshtar e hileqar" (Child Harlod's pilgrimage, II, pasim - dhe gjetkë.) Në thellësi të zemrës së tij, lord Bajroni nuk mund t'ua falte grekëve zhgënjimin që pësoi; i mbushur tejet me kujtime nga lashtësia klasike, kishte fluturuar ai vetë në ndihmë të Greqisë gjithë entuziazëm; por kushedi sa iu desh të vuannte me idealin e plagosur, kur gjeti, në vend të Akilejëve e Tezejëve siç pandehte, Tartarinë, madje pa mendjen e Tartarinë; kur gjeti, në vend të perëndive, bij të Fidias, majmunë dhe marioneta (kukulla teatri); në vend të njerëzve, papagaj; në vend të gojartëve të një gjuhe që do duhej të kishte brishtësinë e lirave dhe shkëlqimin e cim-baleve, skatostomë që venë e flasin shatra-patra një nga zhargonet më të llahtarshme, tek e quajnë edhe atë vetë lordhosss Viroonnn (Lord Bajron) - gjë që me siguri duhet



ta ketë nervozuar e ta ketë bërë njëkohësisht për të qeshur; kur gjeti, në vend të athinasve të dikurshëm, banorë të rëndomtë të Athinës.

Ky zhgënjim, që gati nuk bie në sy në poemat e tij, shfaqet më ndonjë rast në letërkëmbimin e tij në mënyrë krejt të hapur. Kështu, duke bërë të vetën një distikë greke kundër grekëve: ? ???? ???? / ?? ????????? ???? ???? - O Athinë, truall i parë në botë, / Ç'gomerë vete e ushqen ti sot!\*" (\*Po e jap të traskriptuar ashtu siç e lexoj tek lord Bajroni, pa theks, pa shpirt. Letër nga Athina, nga kuvendi franciskan, 7 mars 1811, në përmbledhjen e përmendur. Shënim i autorit Faik Konica), ai e shoqëron gjithë këtë me komente aspak mikluese për grekët. Nga ana tjetër, duke i goditur paraprakisht në pretendimet e tyre zonjat greke që kërkonin të rifitonin famën e modeleve të Fidiasit dhe të Praksitelit, ai thotë: "Gratë shqiptare janë shumë më të bukura nga gratë greke, dhe kostumi i tyre është shumë më piktoresk".

Lord Bajroni shpreh edhe më qartë përshtypjet e veta në letrën e gjatë që ai i shkruante

së ëmës nga Preveza, paragrafë të së cilës po i përmendim: "I dua shumë shqiptarët; nuk janë të gjithë muhamedanë, ka mes tyre edhe fise të krishtera; por feja që kanë, nuk bën dallim të madh nga zakonet dhe mënyra e tyre e të jetuarit. Janë trupat më të mira të ushtrisë turke. Në udhëtim e sipër, kalova një herë dy ditë dhe më pas tri ditë, në një kazermë në Salonë, dhe asnjëherë nuk më kanë zënë sytë ushtarë aq të durueshëm e bindur sa ata, edhe pse kam qenë në garnizonet e Maltës e të Gjibraltarit, ku kam parë mjaft trupa spanjolle, franceze, siciliane e angleze. Asgjë nuk më vodhën dhe gjithnjë kam qenë i mirëprituri i tyre, duke ndarë me mua ushqimet dhe qumështin që kishin". Më pas, Bajroni flet për një shqiptar i cili, pasi e bujti dhe e mikëpriti në vatrën e vet, atë dhe bashkudhëtarët e tij, nuk pranoi të shpërblehej me para; dhe kur Bajroni këmbënguli që të pranonte të paktën disa sekene ari, shqiptari i dha një përgjigje të tillë, bukuria e së cilës do shpërfilllej veç prej shpirttrash gatuan me tregti: "Dua që të më doni, e jo të më

paguani".

"I dua shumë shqiptarët", i shkruante Bajroni së ëmës, duke shprehur njëkohësisht shkakun e një simpatie të tillë, me qëllim që edhe e ëma të ushqente dashuri për ta. Dhe ndjeni tani ironinë dhe urrejtjen e këtyre fjalëve që ai i shkruante mikut të vet Drury: "I dua grekët; janë kopukë qerratenj, me tërë veset e turqve, por pa guximin e tyre" (Letër drejtuar Drury, 3 maj 1810). Të interesuarit janë të lutur të kontrollojnë këtë thënie, ashtu sikurse edhe ato të mëparshmet.

Ja pra, si shprehej lordhoss Vrioonnn duke folur për grekët; dhe këto fjalë mund të shërbenin si pikënisje për një studim interesant e të thellë që ndoshta do nxirrte si konkluzion se, duke luftuar për një popull të përbuzshëm e të përbuzur, lord Bajroni nuk kishte në mendje veçse ata helenë të dikurshëm, krijues të Bukurisë, raca hyjnore e të cilëve prehej, e bërë hi, mbi dheun e Helladës së ripopulluar, dhe ata malësorë të Shqipërisë të cilët, të padjallëzuar në heroizmin që i karakterizonte, kishin pleksur kauzën e tyre

me atë të grekëve të rremë.

(Revista "Albania", 1897)


Kemi përmendur kohët e fundit një fjalë të lord Bajronit për grekët modernë, me anë të së cilës poeti i madh i ka karakterizuar këta të fundit si "kopukë qerratenj". Një lexues nga Rumania na shkruan duke na u lutur që të paraqisim pjesën ku shprehet kjo ide. Me shumë dëshirë! Por ne do dëshironim ta paraprinim pjesën e cituar nga një vërejtje. Praktika e kërkon që të jepem vëllimi dhe faqja çdo herë që përmenden autorë pak të njohur, libra të veçantë apo të rrallë. Kurse veprat e lord Bajronit, të shumëfishuara nga botime të panumërta dhe të përkthyer në shumë gjuhë hasen në tërë bibliotekat; prandaj dhe nuk e pamë të arsyeshme të bezdisnim lexuesin me citime, dhe korrespondenti ynë fare mirë do e kishte kursyer mundin për të na shkruar nëse do të kishte konsultuar botimin më të parë që do t'i binte në dorë të veprave të plota të poetit anglez.

Lord Bajroni i konsideronte grekët si "kopukë qerratenj që i kanë tërë veset e turqve por pa

guximin e tyre". Ja teksti në anglisht: "I like the Greeks, who are plausible rascals, - with all the Turkish vices, without their courage". (The Works of Lord Byron. Ed. Joh Murray, Londres, 1898. - Letters and Journal. Vol. I, f. 266).

Ky është mendimi i Lord Bajronit në moshën njëzet vjeçare, dhe për të qenë më të përpiktë në këtë datë: 3 maj 1810. Trembëdhjetë vjet më vonë, më 28 shtator 1823, pak para se të vdiste në Misolongji, i neveritur nga poshtërsitë dhe shpirtvogëlsitë e grekajës [zuzarisë greke], poeti u jepte grekëve cilësimin "gënjeshtarë me nam": "The worst of them, shkruante ai, is that (to use a coarse but the only expression that will not fall short of the truth) they are such damned liars; there never was such an incapacity for veracity shown since Eve lived in Paradise." [E keqja më e madhe tek ta është (duke e thënë copë si e vetmja shprehje që i afrohet së vërtetës) se ata janë gënjeshtarë me nam; kurrë nuk ka pasur mungesë të tillë ndaj së vërtetës qëkurse Eva jetonte në parajsë]. (Botim i përmendur, vëll. VI, f. 247).

(Revista "Albania", 1905)



# Eruditi menjdemprehtë i mjeshtërisë artistike



Faik Konica, lindi më 15 mars të vitit 1876 në Konicë dhe vdiq më 15 dhjetor të vitit 1942 në Uashington. Konica ishte magjistër i artit dhe letërsisë, aktivist kombëtar dhe shkrimtar shqiptar.

Rrjedh nga një familje e vjetër feudale. Mësimet e para i mori në vendlindje, në gjuhën turke, arabe dhe greke. Mësoi në Shkodër, Kostandinopojë, Francë dhe SHBA. Ishte bir i derës së famshme të bejlerëve të Konicës. Nga e ëma binte gjak me Ali Pashë Tepelenën edhe pse vetë kurrë nuk e ka pohuar. Fliste frëngjishte të kulluar.

Më vonë hyri në liceun perandorak francez të Stambollit, për të kryer pastaj shkollën e mesme në Francë. Ndoqi studimet për filozofi në Dizhon dhe Paris. Më 1912 u diplomua për letërsi në universitetin e Harvardit të SHBA me medalje ari, ndërkohë që është cilësuar nga miqtë e tij si "biblioteka lëvizëse".

Fitoi disa konkurse, duke u nderuar me çmime për aftësitë e tij intelektuale jo të zakonata. Faik Konica qysh i ri e lidhi jetën me veprën e tij dhe me lëvizjen kombëtare shqiptare. Pasi boton broshurën "Shqipëria dhe turqit" (1895) në Paris ai vendoset në Bruksel (Belgjikë), ku nxjerr revistën "Albania", kjo revistë poli-

tiko-kulturore dhe letrare u bë organi më i rëndësishëm e më me autoritet i Rilindjes sonë. E botuar në gjuhën shqipe, frënge dhe pjesërisht turke, si një enciklopedi e vërtetë, ajo propogandoi për vite me radhë (1897-1909) programin e lëvizjes kombëtare shqiptare, historinë dhe kulturën e popullit tonë.

Më 1909 Konica, si u mbyll revista "Albania" në Londër, i ftuar nga



atdhetarët shkon në SHBA ku drejton gazetën "Dielli" edhe më pas gazetën "Trumpeta e Krujës".

Me themelimin e Federatës "Vatra", më 1912 ai zgjidhet sekretar i përgjithshëm i saj. Faik Konica dhe Fan Noli, duke qenë udhëheqësit kryesorë të lëvizjes kombëtare shqiptare në SHBA, do të shkojnë në Londër për mbrojtjen e çështjes kombëtare në Konferencën e Ambasadorëve. Në kongresin shqiptar të Triestes (1913), që u mbledh për të kundërshtuar copëtimin e Shqipërisë nga armiqtë e saj, Konica u zgjodh kryetar. Gjatë Luftës së Parë Botërore dhe më pas, ai zhvilloi

veprimtari të dendur diplomatike në dobi të atdheut, në Austri, Zvicër, Itali e gjetkë.

Në 1921 u kthye në SHBA, ku u zgjodh kryetar i Federatës "Vatra", po ndërkaq në vitet 20 u lidh dhe ndikoi në lëvizjen demokratike që zhvillohej në Shqipëri. Këtë do ta bënte nëpërmjet gazetës "Dielli" dhe "Shqiptari i Amerikës".

Me dështimin e Revolucionit Demokratik dhe me ardhjen e Ahmet Zogut në fuqi, Konica u emërua ministër fuqiplotë i Shqipërisë në SHBA. Ministër i oborrit mbretëror në SHBA (përfaqësues i Shqipërisë), Konica ishte një pianist i shkëlqyer dhe një shkrimtar gjenial.

Ai mbahet si krijuesi i prozës moderne shqipe. Çdo krijues i letërsisë shqiptare që vjen pas tij mund vetëm të quhet nxënës i tij. Faik Konica është një nga personalitetet më në zë të kulturës dhe letërsisë shqiptare.

Prozator dhe poet, publicist dhe estetist, kritik letrar dhe përkthyes, ai me veprën e tij të shumanshme pasuroi dhe ngriti në lartësi të reja fjalën shqipe dhe mendimin letrar shqiptar. Njeri me dituri të madhe dhe dhunti artistike, mjeshtër i hollë i gjuhës shqipe, Konica ka hyrë në historinë e kulturës sonë kombëtare, jo vetëm si erudit e stilist i përkryer, por edhe si shkrimtar me vlera të shquara ideoartistike. /konica.al



# 700 familje do të ndihmohen nga mini-maratona “Vrapo Babadimër”



Kjo mini maratonë e organizuar nga Jusuf Islami me OJQ “Projekti 5Cent” u mbajtë për të katërtën herë në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë ku pritet të kontribuohet për familjet në nevojë

“Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është në rend të parë ngritja e donacioneve për të ndihmuar familjet e varfra në Republikën e Kosovës me rastin

e festave të fundvitit. Te gjitha mjetet e mbledhura gjatë këtij aktiviteti do të ndahen për familjet në nevojë. Në edicionin e parë kemi ndihmuar

gjithsej 60 familje në Prishtinë, në edicionin e dytë kemi ndihmuar 350 familje ndërsa në edicionin e tretë janë ndihmuar 500 familje në 7 qytetet e Kosovës, ku qendrat sociale kanë bërë përzgjedhjen e familjeve. Këtë vit synojmë të ndihmojmë deri në 700 familje në gjithë Kosovën. Për mjetet e mbledhura dhe të shpërndara do të mbahet llogari transparente”, thuhet në një njoftim në

Facebook-un e OJQ “Projekti 5Cent”.

Sipas njoftimit maratona e kaluar ishte shfaqur në mediat më të mëdha botërore, siç janë CNN, BBC, EuroNews si edhe shumë portale botërore dhe të gjitha mediet vendore.

“Pas një kohe të gjatë Kosova po promovohet në këto medie me lajme të mira. Dhe si shtet hymë në mesin e 60’te shteteve të botës me një aktivitet të tillë.

Organizimi i maratonës është i tillë, ku synohet që të krijohen mjete nga shitja e kostumeve të babadimrave për qytetarët pjesëmarrës në maratonë, ndërsa pas maratonës me ato mjete blehen furnizime me ushqime dhe gjëra të nevojshme për familjet në nevojë”, thekson njoftimi.

Ky organizim mbështetet nga Komuna e Prishtinës dhe shumë biznese të tjera. / KultPlus.com

## Gjërat që mund të bëni në një ditë dimri

Ka shumë arsye pse dimri edhe mund të jetë një stinë e preferuar për ju. Festat e fundvitit, skitë, një libër pranë zjarrit, apo një gotë vere e nxehtë.

Sidoqoftë, më poshtë do të gjeni një listë të gjërave që duhen bërë këtë dimër për ta bërë atë një ndër stinët më të paharruara për ju:

1. Provojeni një recetë të re supe.
2. Dilni për të bledhë. Koha e fundvitit zakonisht ka zbritjet më të mira.
3. Lexojeni librin që ka pritur tërë vitin për t’u lexuar nga ju.

4. Shikoni filmat më të përfolur gjatë këtij viti.
5. Vizitoni muzeun apo një ekspozitë që e keni përmendur tash e sa kohë.
6. Organizojeni dollapin tuaj. Dimri është stina perfekte për ta bërë këtë gjë.
7. Testoni aftësitë e juaja të patinazhit.
8. Ndihuni rehat pranë zjarrit.
9. Dilni dhe shëtitni në qytet.
10. Ngjituni maleve.
11. Filloni një plan të ri stërvitjesh.
12. Shkoni për ski.
13. Ndihmoni të tjerët.
14. Shkoni në një pushim larg.
15. Shijojeni marketin e fundvitit. /konica.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Shtatë lojtarët e panevojshëm në pritje të ndarjes me Feronikelin

Shtatë lojtarët e liruar nga Feronikeli ende kanë marrë fletëlëshimet nga klubi për faktin se janë duke pritur që të kryhen obligimet financiare që ka "Nikli" ndaj tyre. Gazeta ka mësuar se të njëjtit kanë arritur marrëveshje me klubet e tjera, por janë duke pritur që të ndahen fillimisht me skuadrën kampione për t'i zyrtarizuar më pas klubet e reja

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Futbollistët e dëshmuar në futbollin e Kosovës si Kastriot Rexha, Astrit Fazliu, Albutrint Morina, Lulëzim Doshllaku, Haxhi Neziraj, Arbër Prekazi dhe Milosh Krkotiq janë liruar nga kampionia në fuqi e Kosovës, Feronikeli me arsyen se nuk bëjnë pjesë në planet e trajnerit Agim Sopi.

Klubi nga Drenasi në njoftimin e mëherëshëm kishte bërë me dije se kontratat nuk janë shkëputur, por futbollistëve në fjalë u është rekomanduar të gjejnë klube të reja sepse "Nikli" planifikon t'u japë rast lojtarëve të rinj. "Kryetrajneri Agim Sopi, së bashku me këshilltarin e presidentit, Albert Bunjaku, kanë bërë biseda individuale me futbollistët të caktuar, të cilët nuk pritet të jenë në planet e

kryetrajnerit për pjesën e mbetur të sezonit dhe po të njëjtëve futbollistët i është sugjeruar të kërkojnë klub të ri, gjithnjë duke mos dashur të kenë negeje në karrierat e tyre", thuhej në njoftimin e Feronikelit.

Ani pse kanë kaluar disa ditë nga ky vendim i klubit kampion, asnjëri nga këta futbollistë nuk është larguar zyrtarisht nga klubi, sepse ata janë duke pritur që të kryhen disa obligime financiare dhe më pas ta ndërprejnë bashkëpunimin me skuadrën që e ndihmuan edicion e kaluar të shpallet kampione dhe fituese e Kupës. Këto ndryshime në klubin nga Drenasi kanë ardhur edhe si pasojë e mbetjes paksa mbrapa në garën për titull, ku pas përfundimit të sezonit vjeshtor "Nikli" është në vendin e pestë me 27 pikë, shtatë pikë më pak se skuadra lidere Ballkani. "Të gjithë futbollistët janë duke pritur që të

kryhen disa obligime financiare nga ana e klubit dhe më pas t'i shkëpusin kontratat", ka thënë një burim i besueshëm i gazetës i afërt me futbollistët e lartpërmendur.

Mbrojtësi Arbër Prekazi është raportuar se ka arritur marrëveshje me skuadrën e Ballkanit nga Suhareka, por ende nuk është prezantuar në këtë klub për shkak se nuk e ka përmbyllur marrëveshjen me skuadrën e Feronikelit. Ndërsa edhe lojtarët e tjerë janë në kontakte me klube të Superligës, por për të njëjtat arsye ende nuk kanë zyrtarizuar marrëveshjet. Nga lojtarët më të kërkuar prej shtatë lojtarëve të lartpërmendur janë Astrit Fazliu dhe Kastriot Rexha. Ky i fundit po kërkohet nga Prishtina, Drita dhe Llapi. "Nikli" mund të dalë sërish në garat evropiane, pasi është kualifikuar në çerekfinale të Kupës ku kundërshtarë do ta ketë Lirinë e Prizrenit.

SHKURT

## Rashica, pas golit ndaj Bayernit: Të qëndrojmë së bashku

Milot Rashica ka vazhduar paraqitjet e mira sa i përket aspektit individual. Sulmuesi i Kosovës ka shënuar për Werder Bremenin golin e vetëm ndaj kampionit në fuqi të Gjermanisë, Bayern Munchen (6-1). "Le të qëndrojmë së bashku për dy ndeshjet e fundit vendimtare të këtij viti. Më shumë se kurrë tani", ka shkruar Rashica. Werderi e pret Mainzin dhe i shkon Kolnit.

## Marku vazhdon me fitore

Boksieri shqiptar, Florian Marku, e ka vazhduar shkëlqimin në boksion profesionist. Marku e mposhti britanikun Nathan Bendon, në meçin që u zhvillua në Mançester në kuadër të turneut "Ultimate Boxer 6". Marku nuk e vuri në diskutim fitoren, duke dominuar në pesë nga gjashtë raundet. Ai fitoi me vendin unanimit, 60-55.

## FFK-ja organizon kamp në Zvicër

Federata e Futbollit e Kosovës në bashkëpunim me Unionin e Klubeve Shqiptare në Zvicër, po e mban kampin e radhës për talentet U-15 në Cyrih. Në këtë kamp dyditor po marrin pjesë 33 futbollistët, me të cilët po punojnë trajnerët Gazmend Haliti, Isa Sadriu dhe Valmir Bytyqi. Ashtu sikurse edhe në kampet e mëparshme, qëllimi është identifikimi i talentëve të reja, të cilët në të ardhmen do t'i bashkohen Përfaqësueses U15, por edhe ekipeve të tjera zinxhirë.

## Kasami e Seferi shënojnë në derbin e shqiptarëve në Zvicër

Pajtim Kasami e ka gjetur sërish golin në Superligën e Zvicrës, ashtu si Taulant Seferi. Dy sulmuesit shqiptarë kanë shënuar në ndeshjen që skuadra e tyre, Sion e Xamax po barazojnë 1-1. Kasami e kaloi në epërsi Sionin në minutën e 28', duke shënuar për 1-0. Kurse, Seferi shënoi për 1-1 me të filluar pjesa e dytë, në minutën e 52'. Për Sionin nga minuta e parë po luan edhe Ermir Lenjani, kurse për Xamaxin titullar është edhe shqiptari tjetër, Samir Ramizi.

## Enis Bardhi i siguron tri pikë skuadrës së Levantes

Futbollisti shqiptar Enis Bardhi ka shënuar një gol të bukur për Levanten në sfidën ndaj Granadas për rezultatin 2-1. Ishte ky goli i dytë për Bardhin këtë edicion të Levante. Bardhi mbron ngjyrat e Maqedonisë së Veriut dhe në marsin e vitin 2020, do të jetë kundërshtar i Kosovës në ndeshjen gjysmëfinale të Ligës së Kombeve që zhvillohet në Shkup.

## Prishtina deklason Bashkimin, Ponte Prizreni mposhti Rahovecin

PRISHTINË, 15 DHJETOR - KB Sigal Prishtina ka mundur Bashkimin me rezultat bindës 120:59 (31:14, 28:17, 25:16, 36:12) në kuadër të javës së 17-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Vendësit e nisën ndeshjen me mirë nga fillimi, duke qenë më të mirë në çerekun e parë, që e fituan me


rezultat 31:14. "Bardhekaltrit" vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, duke e fituar edhe këtë pjesë 28:17, për të shkuar në pushim me rezultat 59:31. Edhe në periodën e tretë kryeqytetasit ishin më të mirë, për të fituar 25:16, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 84:47. Në

dhjetëminutëshin e fundit trajnerët u dhanë hapësirë lojtarëve që kishin më pak minuta, derisa Sigal Prishtina triumfoi në fund me rezultat 120:59. Më të dalluarit te Sigal Prishtina ishin Divine Myles me 24 pikë e 11 kërcime, Fisnik Rugova me 21 pikë e gjashtë kërcime dhe Meriton Ismaili

me 20 e pesë kërcime, kurse te Bashkimi më i miri ishte Corey Ross me 17 pikë. Sigal Prishtina tani ka 12 fitore dhe tri humbje, kurse Bashkimi 11 fitore dhe katër humbje. Ndërsa në ndeshjen tjetër Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 92:88 (29:19, 18:20, 18:24, 27:25).



## Partizani, Teuta, Luftëtari shkarkojnë trajnerët



TI RANË, 15 DHJETOR - Kjo fundjavë e kategorisë superiore ishte e zezë për disa prej trajnerëve dhe jo vetëm për rezultatet e skuadrave të tyre në ndeshjet e radhës. Partizani, Teuta, Luftëtari kanë mbetur pa trajnerë pasi drejtuesit e tyre vendosën t'i largojnë trajnerët respektivë. Franco Lerda i ka thënë lamtumirë skuadrës kampione të vendit, Partizanit. Humbja në derbin me Tiranën në "Air Albania Stadium" që solli edhe zbritjen në klasifikim të "Të Kuqve" duket se pati ndikimin më të madh të drejtuesit e klubit kryeqytetas për marrjen e vendimit

për ta ndërprerë bashkëpunimin me të. "Presidenti Demi i uron trajnerit Lerda suksese të mëtejshme në karrierën e tij sportive", thuhet në njoftim.

Të njëjtin fat si Franco Lerda pati edhe Bledi Shkëmbi te Teuta. Klubi dursak njoftoi shkarkimin e 40-vjeçarit thuajse në të njëjtën kohë me vendimin e publikuar edhe nga Partizani për trajnerin italian. Humbja 4-0 me Kukësin rezultoi një goditje e fortë për klubin dursak që tani e sheh veten në vendin e 7 në renditje me 22 pikë, vetëm 2 pikë më shumë se Skënderbeu që është në vendin e

8. "Falënderojmë trajnerin në fjalë për kontributin e dhënë gjatë kohës që ishte pjesë e jona. Ne i urojmë Shkëmbit suksese në jetë dhe në karrierë", thuhet në njoftim. Por vala e shkarkimeve në superiore nuk mbyllet me kaq. Edhe Jorgos Marantas i ka dhënë fund aventurës së tij në futbollin shqiptar pasi është shkarkuar si trajner i Luftëtarit, diçka që është konfirmuar nga vetë drejtuesit e klubit nga Gjirokastra të cilët në të njëjtën kohë bënë të ditur se trajneri grek për dy ndeshjet e fundit të 2019 do të zëvendësohet nga Neritan Novi.

## Mposhten Houstoni dhe Dallasi

HOUSTON, 15 JANAR - 39 pikët e James Hardenit nuk i mjaftojnë Houston Rocketsit që pësoi disfatën e nëntë sezonale pasi u mposht brenda në "Toyota Center" nga Detroit Pistonsi me rezultatin 107-115. Përveç 39 pikëve, Hardeni koleksionoi dhe 6 rebounde e 7 asistime, por Houstoni me këtë humbje rrëshqiti në vendin e 5-të të Konferencës së Perëndimit. Ra pas 4 fitoresh radhazi Los Angeles Clippersi që u mposht 109-106 nga Chicago Bulls në "United Center" në një ndeshje ku më i miri mbi parket ishte Zac LaVine i vendësve me 31 pikë. Një ndeshje shumë e luftuar ishte ajo e zhvilluar në "American Airlines Center" të Dallasit ku skuadra teksane pësoi disfatën e tetë sezonale pasi u mposht me rezultatin 118-122 pas kohës shtesë nga Miami Heatit që në krahun tjetër arriti suksesin e 19 sezonal.



Dëmtimi i yllit sloven Luka Doniq, pas vetëm 1 minutë e 40 sekondash lojë, i prishi planet Dallasit, teksa 28 pikët e Hardaway nuk i mjaftuan Dallasit, ndërkohë te miqtë nga

Florida spikati Jimmy Butler me 27 pikë. Suksese të thjeshta për Milwaukee Bucks dhe Toronto Raptors që mposhtën Cleveland Cavaliers 125-108 dhe Brooklyn Nets 110-102.

### SHKURT

#### Hysaj largohet nga Napoli, nëse nuk preferohet nga Gattuso

Mbrojtësi shqiptar Elseid Hysaj mund të largohet në janar nga Napoli. Agjenti i Hysajt, Mario Giuffredi, ka folur për "Radio Kiss Kiss" rreth të ardhmes së mbrojtësit në klubin e Napolit. 25-vjeçari ishte një titullar i padiskutueshëm te Napoli, por këtë edicion ka qëndruar në bankën rezervë pasi nuk preferohej nga ish-trajneri i Napolit, Carlo Ancelotti. "Sapo jam takuar me drejtorin Giuntoli dhe presidentin De Laurentis ku biseduam për Hysajn. Ne kemi pritur që ai të luante më shumë, por Ancelotti me qëllim e la atë në bankë. Shpresoj që Gattuso ta aktivizojë atë më shumë dhe të qetësohet lojtari. Nëse Hysaj nuk aktivizohet nga Gattuso, atëherë ne do të largohemi gjatë afatit kalimtar të janarit pasi ka oferta për të", ka deklaruar Giuffredi.

#### Zidane: Mbappe? Është lojtar i PSG-së

Javë më parë Zinedine Zidane ishte në qendër të vëmendjes pasi kishte deklaruar se: "E dua Mbappen". Mirëpo tash trajneri i Realit ka heshtur, pas reagimeve të shumta që kishin ndodhur për shkak të asaj deklarate. "Kylian është lojtar i PSG-së, s'do të komentoj gjëra që ndodhin atje. Kjo do të tregonte mungesë respekti. Për të tjerat, njerëzit janë të vetëdijshëm se e njoh mirë Mbappen, por më duhet të tregoj respekt", ka thënë Zidane.

#### Barça në pritje të Guardiols


Barcelona po pret trajnerin Pep Guardiola. Spanjollit po vuan këtë sezon në Premierë Ligë dhe pas dy sezoneve të mbushur me trofe mund të largohet në fund të sezonit, pasi duket se kampionati do të jetë i Liverpoolit, ndërsa Liga e Kampionëve mbetet një objektiv madhor. Kampionët e Spanjës mund t'i ndërpresin rugët me trajnerin Ernesto Valverde në fund të edicionit, pasi nuk janë të kënaqur nga puna e tij. Fitimi i kampionatit dhe Liga e Kampionëve mund ta shpëtonte numrin një të stilit. Ëndrra e madhe mbetet rikthimi i Pep Guardiols, pasi në mediet angleze doli në dritë klauzola që mund ta largojë pa detyrime në fund të edicionit nëse të dyja palët janë dakord. Tekniku ka hedhur poshtë zërat se ekziston një klauzolë e tillë, por asnjëherë nuk i dihet. Trajneri spanjoll mund të rikthehet në shtëpi dhe t'i japë Barcelonës sërish impulsin që i mungon në fushë.

#### Monza, ofertë interesante për Ibrahimoviçin

Skuadra e Monzas i ka ofruar Zlatan Ibrahimoviçit një kontratë për dy vjet e gjysmë. Monza është seriozisht në garë, pasi Adriano Galliani e Silvio Berlusconi planifikojnë të ribashkohen me suedezin, i cili është lojtar i lirë, pasi i dha fund aventurës së tij prej dy sezoneve në MLS, me LA Galaxy. Milan, gjithashtu, është i interesuar për shërbimet e Ibras, duke u konsideruar si një nga skuadrat favorite për nënshkrimin e tij.

#### Inaugurohet stadiumi i ri shtatë muaj para fillimit të Lojërave Olimpikë

Shtatë muaj para fillimit të Lojërave Olimpikë, në Tokio është inauguruar stadiumi i ri i futbollit, në të cilin do të zhvillohen edhe aktivitetet të olimpiadës. Në fillim të janarit do të luhet finalja e 'Emperor Cup Soccer', ku pritet të dhurohet spektakël në stadiumin e ri. Stadiumi ka një kapacitet prej 68 mijë ulëseve dhe është inauguruar nga kryeministri japonez Shinzo Abe, tri vjet pas fillimit të punimeve. Stadiumi është ndërtuar në hapësirën e njëjtë ku qëndronte edhe stadiumi që u përdor në olimpiadën 1964.

		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>		SHARRËZ (shq.)	PJESA E BRENDSHME E TEMPULLIT GREK KU MUND TË HYJË VETËM PRIFTI	ZULMË	KOHË BRENDË SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË VEPRIM	AKTORJA E NJOHUR SPELLING	OLIVER NEUVILLE	NGADHËNJIM NË NJË BETEJË	ZANORE	QYTET BREGDETAR NË ITALI	GRIMCOVA (bised.)	SHKRONJA TË NJËJTA		
		FRIKA PATOLOGJIKE NGA VDEKJA														
		TËRËSIA E GJALLESAVE NË TOKA											BIMË MËMË (shq.) REGJISORJA ... ELEZI (shq.)			
		PRONË E VOGËL E SPAHINJVE FEUDAL OTOMAN									TINARI MARC ANTHONY					KËNGËTARJA ... HOXHA
		ARTIOLA TOSKA					SHTET NË AZI ... LINDOR VRAPIMI MË I GJATË NË ATLETIKË								ZANORE ÇMENDJE (sh.shq.)	
		LIGJ, KANUN (vjet.)							SHKRIMTARJA KAMBERI	BISHË MALI (pashq.) I PËSHPËRITA FJALË MAGJIKE					DY BASHKËTINGËLLORE POEZI LIRIKE PËRVAJSHME E PLOT DHEMBJE BIM	
		BASKETBOLLI ISTI TURK OMER ... (shq.)									KUNDËRSH-TARI I BOLSHEVIZMIT RUS ARCHITECTURE RESEARCH OFFICE					
ALARM I AUTOMJETIT BATARE										DËSHMORI ... KODRA (UÇK) FJALË E RËNDË (krah.)						
<b>EPOKA E RE</b>	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO	MBARIMI I BOTËS (pashq.)	SHTET I MADH AZIATIK	ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË	"RIZONI" FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.)		LLOJ PAPANALLI EPOKË (shq.)					PJATA OKSIGJEN, NATRIUM				
PJESË E SIPËRME KOSTUMIT, ME MËNGË E ME JAKË TË KTHYER	○														NGADALË, JO SHPEJT (turq.)	
MBISHKRIM NË NJË GUR VARRI	○															
LLOJ VEPRE MUZIKORE	○															
U ARRATISA	○															
KALJARI, ATALANTA	○															
KËNGËTARJA E FAMSHME KANADEZE MORISSETTE	○															
KËNGËTARJA NDOCI VARG MALESH TË LARTA DHE TË ASHPRA	○															
➔	○															
BRITISH SOCIETY RHEUMATOL.	○															
ZANORE	○															
<b>EPOKA E RE</b>	FILLESTAR FLUTURAKE JASHTËTOKËSORE															
"URUGUAI"																
LLOJ SHPENDI FUTBOLLISTI ... VAN PERSIE																
➔																
ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: TANATOFBIA, EDAPONI, AMA, TIMAR, TIRA, AT, TIMORI, E, NOM, ARI, TL, OVANI, ESERI, SIRENA, LAZ, I, ARARA, ENA, XHAKETA, ETIMOLOGJI, EPITAF, ROMA, ANIMA, SONATA, ANATEMA, EV, IKA, ILA, ANIME, ATA, KA, AM, PA, E SITUR, SH, ALANIS, TE, AN, AN, ROK, AIDA, A, OMI, E KAMUR, ALPE, ELIMINIM, GAMA, BSR, LOKEREN, PATA, A, I, KAM, TAM, MINIRE, AMATOR, TIPAR, K, P, UR, ZONAT, TAKAT, KI, FAZAN, MINUK, TETOR, ROBIN, SAMIR, MILETI.																

Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo - Kosovo Cumhuriyeti  
 Ministria e Shëndetësisë  
 Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
 SESKUK - UBESK - KUBK  
 SPITALI I PËRGJITHSHËM OPSTA BOLNICA GENEL HASTANE  
 "Prim. Dr. Daut Mustafa"  
 Njësia Org. I N. Prot. 8/5u  
 Org. Jedinica Org. Bolnični Prot. No.  
 Nr. i fazeve Datum: 12.12.2019  
 Br. stranicë Tarikh: R E N

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
 Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
 Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosovo - Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
**Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital**  
**"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"**  
 Prizren

Në bazë të nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe shkresës së SHSKUK-së (pranuar në E-mail, datë 20.11.2019), Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren të mbledhjen e mbajtur më 12.12.2019, nxori këtë vendim:

**Përsëritet Konkursi Publik**

**Nr. 8/41 për pozitat:**  
 1. Teknik i lartë laborant – 2 (dy) pozita  
**Nr. 8/42 për pozitat:**  
 1. Mjekë specialistë urolog - 1 (një) pozitë  
 2. Fizioterapeut Bachelor – 2 (dy) pozita  
 3. Farmacist i diplomuar – 1 (një) pozitë  
 Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data e publikimit në një mjet të informimit, pikat tjera të konkursit mbeten të njëjta.

U skladu sa ç'është 13.11 Statuta opšte bolnice, članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i pismo SHSKUK (primljeno na emajlu, dana 20.11.2019), Upravni Savet opšte bolnice "Prim.dr. Daut Mustafa" Prizren na sastanku održanu 12.12.2019 izdao je sledeće odluku:

**Ponavlja se Javni Oglas**

**Br. 8/41 za pozicije:**  
 1. Vise tehnički laborant – 2 (dve) pozicije  
**Br. 8/42 za pozicije:**  
 1. Lekar specijalista urologa - 1 (jedna) pozicije  
 2. Fizioterapeut bachel - 2 (dve) pozicije  
 3. Diplomirani farmacist + 1 (jedna) pozicije  
 Oglas ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od medija, ostale tačke ostaju iste.

Hastane Statüsü'nün 13üncü maddesinin 1.1 fıkrasına göre, Konkür işlemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin desteğiyle, aynı zamanda HKUK'nin mektubuna (20.11.2019 tarihinde kabul edilen e-postasına) dayanarak "Genel Hastane "Prim. Dr. Daut Mustafa" Yürütme Kurulu 12.12.2019 tarihli toplantısında şu kararı verdi:

**İş ilânının tekrarı**

**Nr. 8/41 konumlar:**  
 1. L. Kidemli laboratuvar teknisyeni - 2 (iki) konum  
**Nr. 8/42 konumlar:**  
 1. Uzman doktor - 1 (bir) konum  
 2. Fizyoterapist Bachelor - 2 (iki) konum  
 3. Mezun Eczacı - 1 (bir) konum

İlan, medya kuruluşunda yayınlanmasından 15 gün açık olacaktır, ilanın diğer noktaları aynı kalmaktadır.

12.12.2019

Drejtoresha e Administratës  
 Ma. Sci. Melinda Çolaku

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentsisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

**Lume's Details**  
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**  
 TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553


PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook  www.facebook.com/giejpuneshpeite

# SIGMA



## VIENNA INSURANCE GROUP

**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË**

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)